



Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Kosovë

Përmbledhje e Raportit të Vlerësimit

Dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

<i>Përmbledhje ekzekutive</i>	4
Kërcënimet.....	4
Cenueshmëria.....	6
<i>Hyrje</i>	8
<i>Metodologjia dhe përkufizimet e vlerësimit të rrezikut</i>	9
Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar për PP/FT në Kosovë.....	11
Terminologjia dhe konceptet kyçe	12
Procesi i identifikimit të kërcënimeve dhe cenueshmërive	13
<i>Kërcënimi nga pastrimi i parave</i>	14
Evazioni fiskal.....	14
Korrupsioni dhe ryshfeti.....	16
Trafiku i drogës	17
Opiatet.....	18
Marihuana	19
Kokaina	19
Falsifikimi dhe pirateria e produkteve	19
Kontrabanda	20
Trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabanda e emigrantëve	21
Trafikimi i qenieve njerëzore.....	21
Kontrabanda e emigrantëve.....	22
Prostitucioni	23
Mashtrimi.....	23
Zhvatja dhe fajdet	24
Grabitja ose vjedhja	25
Krimet Kibernetike	26
Krimi mjedisor.....	27
Tregtia e paligjshme e armëve.....	28
Falsifikimi.....	29
Falsifikimi i monedhës.....	29
Trafikimi i paligjshëm në mallra të vjedhura dhe të tjera	30
Të ardhurat ndërkombëtare të flukseve të krimit.....	31
Flukset hyrëse.....	31
Flukset dalëse.....	34
<i>Kërcënimi nga financimi i terrorizmit</i>	35
<i>Cenueshmëritë në subjektet raportuese</i>	36
Bankat.....	36

Dërguesit e parave dhe agjentët e transfertave.....	38
Agjentët e këmbimit valutor	40
Institucionet mikro-financiare.....	41
Kompanitë e Sigurimeve	42
Lizingu financiar.....	43
Fondet pensionale	44
Patundshmëritë dhe Ndërtimtaria	44
Noterët	46
Personat juridik dhe aranzhimet	47
Lojërat e fatit	48
OJQ-të	49
Tregtarët me vlera të larta.....	51
Avokatët.....	52
Kontabilistët dhe auditorët	53
Kazinot në Internet.....	54

LISTA E AKRONIMEVE

PPP/KFT	Parandalimi i pastrimit të parasë dhe Kundërmaset ndaj financimit të terrorizmit
PP	Pastrimi i parave
FT	Financimi i Terrorizmit
ProP	Pronësi Përfituese
KDK	Kujdesi i Duhur ndaj Klientit
KDZ	Kujdesi i Duhur i Zgjeruar
BPPJF	Bizneset dhe profesionet e përcaktuara jo-financiare
FATF	Task Forca e Veprimit Financiar
NJIF-K	Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare e huaj
VRK	Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar
PEP	Persona të Ekspozuar Politikisht
SAEK	Mbështetja në Përpjekjet Kundër Korrupsionit në Kosovë
RTD	Raport i Transaksionit të Dyshimtë
UNCAC	Konventa Kundër Korrupsionit e Kombeve të Bashkuara.
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

Përmbledhje ekzekutive

Ky është vlerësimi i dytë i rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë (VRK). Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, qëllimi është të identifikohen, të kuptohen dhe të vlerësohen rreziqet e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me të cilat përballet Kosova. Terminologjia dhe metodologjia e VRK-së bazohet në Udhëzimin Administrativ MF-Nr.04/2018 për vlerësimin e rrezikut kombëtar për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, udhëzimin e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF), organizëm ndërkombëtar për përcaktimin e standardeve për masat mbrojtëse kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit. Konceptet themelore për vlerësimin e rrezikut janë kërcënimet (veprat penale të përshkruara që lidhen me pastrimin e parave), cenueshmëritë (mundësitë që e mundësojnë pastrimin e parave), pasojat (ndikimi i një cenueshmërie), dhe rreziku (sinteza e kërcënimit, cenueshmërisë dhe pasojës)

Ky vlerësim është zhvilluar nën mbështetjen e UNDP Kosovë, Projektit mbështetje për përpjekjet kundër korrupsion në Kosovë (SAEK)¹.






Kërcënimet

Pastrimi i parave është një pasojë e domosdoshme e të gjitha krimeve që gjenerojnë përfitime, dhe përderisa është e vështirë të vlerësohet me saktësi sa para pastrohen në Kosovë, ka gjasa që shifrat të jenë qindra miliona euro çdo vit.

Figura 1 thekson sasinë e të ardhurave të gjeneruara në Kosovë nga secili lloj krimi, duke treguar se evazioni fiskal dhe korrupsioni gjenerojnë shumën më të madhe të të ardhurave. Evazioni fiskal në Kosovë është i lidhur fort me përhapjen e gjerë të informalitetit të ekonomisë, gjë që mundëson që fitimet të raportohen pjesërisht ose aspak. Derisa disa forma të korrupsionit gjenerojnë të ardhura në Kosovë korrupsioni i lidhur me prokurimin shihet që i gjeneron të ardhurat më të mëdha, dhe lidhet shpesh me Personat e Ekspozuar Politikisht (PEP).

¹ Opinione e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të UNDP-së apo të shteteve anëtare të saj.

Figura 1 Niveli i kërcënimit të pastrimit të parave nga veprat penale të përshkruara

Veprat penale të përshkruara	Niveli i kërcënimit
Evazioni fiskal Korrupsioni dhe ryshfeti	 Jashtëzakonisht i lartë
Trafiku i drogës Kontrabanda Falsifikimi dhe pirateria e mallrave Trafikimi i qenieve njerëzore Prostitucioni	 I lartë
Mashtrimi Grabitja dhe vjedhja Zhvatja dhe fajdet Krimet Kibernetike	 Mesatar
Trafikimi i paligjshëm i armëve Krimet mjedisore	 I ulët
Falsifikimi i monedhës Trafikimi i paligjshëm me mallra të vjedhura Falsifikimi	 Jashtëzakonisht i ulët

Trafikimi i drogës, kontrabanda, falsifikimi dhe pirateria e mallrave, mashtrimi, trafikimi i qenieve njerëzore dhe prostitucioni, përveçse janë në nivelin e dytë të gjenerimit të të ardhurave në Kosovë, janë edhe lloje të krimit ku shumica e të ardhurave mendohet se dalin nga Kosova dhe në përgjithësi do të rrjedhin në vendin e lidhur me krimin.











Shumica e llojeve të krimit bëjnë që pjesa kryesore e të ardhurave të marrin formën fillestare të parave të gatshme dhe përdorin metoda relativisht të pasofistikuara të pastrimit, gjë që fuqishëm mundësohet nga informaliteti i madh i ekonomisë së Kosovës që e bën të vështirë të dallohet nëse fondet janë fituar në mënyrë legjitime apo jo. Mendohet se vetëm mashtrimi dhe korrupsioni i nivelit të lartë bëjnë që pjesa kryesore e të ardhurave të tyre të marrin formën fillestare të aseteve financiare.

Kosova nuk ka qenë kurrë shënjestër e sulmeve të mëdha terroriste, megjithatë duke e marrë parasysh, ndër të tjera, faktin se Kosova ka pasur luftëtarë që kanë shkuar në Siri dhe Irak, dhe një numër i konsiderueshëm i tyre janë kthyer në Kosovë, Kosova nuk mund ta injorojë kërcënimin nga financimi i terrorizmit (FT). Duke e marrë parasysh kërcënimin vendor të terrorizmit, kërcënimi më i rëndësishëm nga FT-ja vjen ose nga vetëfinancimi ose donacionet më të vogla nga donatorët e vullnetshëm/jo të vullnetshëm, ndërkohë që FT përmes OJQ-ve, të cilat përfshijnë burime financimi jashtë Kosovës, poashtu përbëjnë një kërcënim thelbësor.

Cenueshmëria

Vlerësimi tregon se ka shumë kanale që aktualisht ofrojnë mundësi për pastruesit e parave dhe financimin e terrorizmit në Kosovë. Figura 2 tregon shkallën e vlerësuar të parave të pastruara nga lloje të ndryshme të subjekteve raportuese në Kosovë që janë të përfshira në pastrim dhe sasinë e parave që potencialisht mund të përdoren për financimin e terrorizmit (FT).

Figura 2 Niveli i cenueshmërisë nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit nga subjektet raportuese

Lloji i subjektit raportues	Cenueshmëria nga pastrimi i parave	Lloji i subjektit raportues	Cenueshmëria nga financimi i terrorizmit
Bankat Patundshmëritë dhe Ndërtimtaria	Jashtëzakonisht e lartë 		Jashtëzakonisht e lartë 
Noterët Lojërat e fatit Personat juridik dhe aranzhimet Dërguesit e parave dhe agjentët e transfertave	E lartë 	Bankat OJQ-të Dërguesit e parave dhe agjentët e transfertave	E lartë 
OJQ-të Agjentët e këmbimit Tregtarët me vlera të larta	Mesatare 	Tregtarët me vlera të larta Kompanitë mikro-financiare	Mesatare 
Kontabilistët dhe Auditorët Kompanitë e Sigurimeve, Mikro-financa Kazinot në Internet Avokatët Lizing financiar	E ulët 	Auditorët	E ulët 
Fondet pensionale	Jashtëzakonisht e ulët 	Të gjitha subjektet tjera raportuese	Jashtëzakonisht e ulët 

Pavarësisht faktit se sektori bankar konsiderohet të jetë sektori me kontrollet më të forta të PP/FT-së dhe se zotëron të kuptuar solid të rrezikut të tyre të PP/FT-së, ende konsiderohet i cenueshëm nga PP/FT-ja për shkak të natyrës, shkallës dhe kompleksitetit të sektorit dhe rolit të tij qendror në shërbimet financiare të Kosovës.

Në përgjithësi pranohet se sektori i patundshmërive dhe ndërtimtarisë është shumë tërheqës për shumë persona të pastrimit të parave, dhe kjo është pjesërisht për shkak të përhapjes së gjerë të informalitetit të ekonomisë, i cili lejon që pagesat e paligjshme në para të gatshme të mos zbulohen. Gjithashtu, besohet se kompanitë e patundshmërive dhe të ndërtimit janë mjeti mbizotërues fundor i fondeve nga korrupsioni i nivelit të lartë.

Si OJQ-të ashtu edhe remituesit e parave/agjentët e transfertave konsiderohen së kanë një cenueshmëri të lartë nga FT-ja. Për remituesit e parave, kjo është fuqishëm e lidhur me llojin e biznesit, pavarësisht përcjelljes së standardit ndërkombëtar të industrisë për PPP/LFT. Derisa deri më sot nuk ka prova të drejtpërdrejta për keqpërdorimin e sektorit të OJQ-ve për qëllimin e financimit të terrorizmit, dhe shumica dërrmuese e OJQ-ve janë në rrezik të ulët për FT, pranohet se pasqyra aktuale në lidhje me sektorin e bamirësisë nuk është e plotë dhe ka pak mbikëqyrje efektive mbi financimet hyrëse/dalëse.

Në anën tjetër, fondet e pensioneve, kompanitë e sigurimeve dhe të lizingut financiar janë në mesin e subjekteve raportuese që vlerësohen se e kanë nivelin më të ulët të cenueshmërisë nga PP/FT, kështu që janë kandidatë potencial për vëmendje më të lehtë mbikëqyrëse ose për zbatimin e kontrolleve të thjeshtuara PPP/LFT.

Hyrje

Paraja është faktori shtytës në një sërë krimesh, përfshirë trafikun e drogës, korrupsionin, evazionin fiskal, mashtrimin, vjedhjen, trafikimin me qenie njerëzore dhe kontrabandën. Edhe terroristët varen nga mbështetja financiare. Këto krime shkaktojnë humbje të drejtpërdrejta financiare për individët, e dëmtojnë komunitetin, dhe në disa raste shkaktojnë edhe humbje të jetës njerëzore. Pastrimi i suksesshëm i parave ua mundëson kriminelëve t'i shijojnë përfitimet dhe ta zgjerojnë ciklin e kriminalitetit duke siguruar fonde për ri-investim në krim. Kosova është e përkushtuar në zhvillimin dhe mbajtjen e politikave të PPP/LFT-së për ta rritur aftësinë e saj për t'iu përgjigjur rreziqeve në zhvillim të PP/FT-së dhe për ta siguruar të luftuarit efektiv të PP/FT-së.

Objekti i VRK-së është që t'i kuptojë më mirë rreziqet nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit në Kosovës, të informojë ndarjen efikase të burimeve dhe t'i zbusë ato rreziqe. Teksa ky vlerësim nuk duhet të përdoret në izolim, të kuptuarit e përmirësuar që ai ofron duhet t'i ndihmojë qeverisë, agjencive të zbatimit të ligjit, mbikëqyrësve dhe sektorit privat në shënjestrimin e burimeve të tyre në fushat e rrezikut më të lartë, duke siguruar që qasja e Kosovës për parandalimin e krimit financiar është e bazuar në rrezik dhe është proporcionale.

Ky është VRK i dytë për Kosovën dhe bazohet në përvojën dhe njohuritë e VRK-së së parë në vitin 2013². Procesi i mbledhjes së të dhënave dhe i hartimit u mbështet nga Projekti i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) Mbështetja në Përpjekjet Kundër Korrupsionit në Kosovë (SAEK II), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Kosovë dhe Agjencia Daneze për Zhvillim Ndërkombëtar (DANIDA). Përveç kësaj, kjo VRK është poashtu e informuar në pjesë nga tre vlerësime të ridërguara të rrezikut sektorial: Biznesi i ndërtimit; Sektori i lojërave të fatit; dhe sektori i OJF-ve.

Kapitulli i parë jep një përshkrim të metodologjisë dhe përkufizimeve të përdorura për t'i vlerësuar rreziqet e PP/FT-së në Kosovë; kapitulli i dytë paraqet rezultatet e vlerësimit të kërcënimeve nga PP-ja; kapitulli i tretë konsideron kërcënimet nga FT-ja; ndërsa kapitulli i katërt përmban rezultatet e vlerësimit të cenueshmërive nga PP/FT-ja të subjekteve të ndryshme raportuese në Kosovë.


² http://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/02/NRA_Summary_ENG.pdf

Metodologjia dhe përkufizimet e vlerësimit të rrezikut

Mekanizmi i menaxhimit të rrezikut për pastrim të parave dhe financim të terrorizmit në Kosovë bazohet në standardet ndërkombëtare. Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar për Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit në Kosovë 2019 përdor Udhëzuesin e FATF-së për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar për Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit, si dhe standardet³ ISO 31000⁴ dhe 31010⁵.

Udhëzuesi i FATF-së për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar për Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit⁶ përbëhet nga identifikimi, analiza dhe vlerësimi i rreziqeve. Procesi është i përshkruar më poshtë.

Figura 3 Procesi i Vlerësimit të Rrezikut për Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit



Burimi: Udhëzuesi i FATF-së për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar për Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit 2013

³Udhëzuesi i FATF-së për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar për Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit, 2013

⁴Menaxhimi i rrezikut - Parimet dhe udhëzimet, Standardi Ndërkombëtar ISO 31000, 2009.


⁵Menaxhimi i rrezikut - Teknikat e vlerësimit të rrezikut, Standardi Ndërkombëtar ISO 31010, 2009.

⁶Udhëzuesi i FATF-së për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar për Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit, 2013.

Standardet ISO 31000 dhe 31010 i përcaktojnë procedurat e përgjithshme të vlerësimit të rrezikut dhe menaxhimit të rrezikut. Ministria e Financave ka nxjerrë një Udhëzim Administrativ⁷ i cili në detaje e përcakton procesin e vlerësimit të rrezikut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Procesi i hartimit, takimet e grupit punues dhe mbledhja e të dhënave u mbështet nga Projekti i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) Mbështetja për Përpjekjet Kundër Korrupsionit në Kosovë (SAEK II), i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) në Kosovë dhe Agjencia Daneze për Zhvillim Ndërkombëtar (DANIDA).

Mekanizmi i menaxhimit të rrezikut në nivel kombëtar dhe Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar për Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit në Kosovë përdor këto standarde ndërkombëtare, të cilat përbëhen nga fazat e mëposhtme:

Figura 4 Procesi i analizës dhe menaxhimit të rrezikut



Burimi: Standardet ISO 31000 dhe 31010

⁷Udhëzimi Administrativ MF - Nr. 04/2018 për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar për Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit, Ministria e Financave, 2018.

Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar për PP/FT në Kosovë

Objektivat e vlerësimit të rrezikut janë vlerësimi i mundësisë së ngjarjeve ose rrethanave të ardhshme dhe i efekteve të tyre mbi parandalimin dhe zbulimin efikas të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Vlerësimi i rrezikut do të sigurojë informata për institucionet publike, private dhe të sektorit të tretë në procedurat e tyre vendimmarrëse në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare në Kosovë.

Për këtë qëllim, NJIF-K ka themeluar një Grup Punues të Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar, i cili komunikon dhe konsultohet me partnerët përkatës për mbledhjen e informacionit. Qëllimi është që të identifikohen, të analizohen dhe të vlerësohen rreziqet. Grupi punues përbëhet nga:

- Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës;
- Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit;
- Administrata Tatimore e Kosovës;
- Policia e Kosovës;
- Doganat e Kosovës;
- Agjencia e Kosovës për Inteligjencë;
- Ministria e Financave e Kosovës;
- Banka Qendrore e Kosovës;
- Shoqata e Bankave të Kosovës;
- Oda e Noterëve të Kosovës;
- Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar
- Projekti i financuar nga BE-ja "Përkrahje për institucionet e Kosovës në luftimin e krimit financiar dhe ekonomik";
- UNDP Support to Anti-corruption Efforts in Kosovo (SAEK II) project

Burimet objektive të përdorura nga Grupi Punues për Vlerësimin e Rrezikut gjatë komunikimit dhe konsultimit me partnerët përkatës për mbledhjen e informacionit, përbëhen nga:

- Mbledhja dhe analizimi i statistikave që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet ekonomike dhe krimet financiare;
- Mbledhja dhe analizimi i statistikave që lidhen me përpjekjet e PPP/LFT-së dhe ekspozimi i subjekteve relevante raportuese.
- Mbledhja dhe analizimi i shembujve të rasteve që kanë të bëjnë me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet financiare.

Për komunikimin dhe konsultimin me partnerët përkatës do të përdoren burimet vijuese subjektive të informatave:

- Mbledhjet e Grupit Punues për Vlerësimin e Rrezikut;
- Intervistat dhe takimet me përfaqësuesit e institucioneve përkatëse private dhe publike;
- Anketa e perceptimit të kërcënimeve dhe cënueshmërive në lidhje me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet financiare;

Terminologjia dhe konceptet kyçe

Menaxhimi i rrezikut duhet të sigurojë që organizatat të jenë në gjendje të kryejnë aktivitete të koordinuara për të drejtuar dhe kontrolluar funksionet e tyre në lidhje me rreziqet. Andaj, është e rëndësishme që kërcënimet dhe cenueshmëritë të shqyrtohen sipas pasojave të tyre dhe gjasave që rreziku të materializohet. Terminologjia dhe metodologjia e VRK-së bazohet në udhëzuesin e FATF-së⁸, i cili paraqet një proces për kryerjen e një vlerësimi të rrezikut në nivel kombëtar. Kjo qasje përdor konceptet kyçe si në vijim:

Kërcënimet: Këto janë të ardhurat nga veprat penale të përshkruara që lidhen me pastrimin e parave dhe fondet për financimin e terrorizmit. Të kuptuarit e mjedisit të kërcënimeve është thelbësor për t'i kuptuar cenueshmëritë që krijojnë mundësi të pastrimit të parave.

Cenueshmëria: Të gjitha ato gjëra që mund të shfrytëzohen nga një kërcënim ose që mund t'i mbështesin ose t'i lehtësojnë aktivitetet e tij. Në kuadër të kontekstit të PP/FT-së, vlerësimi i cenueshmërive nënkupton shqyrtimin e faktorëve që paraqesin dobësi në sistemet ose kontrollet e PPP/LFT-së brenda një juridiksioni. Ato gjithashtu mund t'i përfshijnë tiparet e një sektori të caktuar, një produkt financiar ose një lloj shërbimi që i bën atraktive për qëllime të PP-së ose FT-së.

Pasoja: Kjo i referohet ndikimit ose dëmit që mund të shkaktojë PP-ja ose FT-ja, dhe përfshin efektin e veprimtarisë themelore kriminale dhe terroriste në sistemet dhe institucionet financiare, si dhe në ekonominë dhe shoqërinë në përgjithësi. Për qëllime të këtij vlerësimi të rrezikut, dhe në përputhje me metodologjinë e VRK-së, komponenti i pasojave konsiderohet vazhdimisht i rëndësishëm, andaj nuk do të trajtohet në mënyrë të detajuar. Për rrjedhojë, metodologjia e propozuar përqendrohet në komponentet e kërcënimeve dhe cenueshmërive.

Rreziku: Është një funksion i kërcënimeve, cenueshmërive dhe pasojave, dhe zbutet nga faktorë dhe rrethana të caktuara. Një vlerësim i rrezikut përfshin marrjen e vendimeve mbi kërcënimet, cenueshmëritë, zbutjen dhe pasojat.

⁸ Udhëzuesi i FATF-së për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar për Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit, 2013

http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/content/images/National_ML_TF_Risk_Assessment.pdf

Procesi i identifikimit të kërcënimeve dhe cenueshmërive

VRK-ja i përdor të gjitha informacionet e disponueshme për t'i identifikuar, sa më objektivisht që të jetë e mundur, rreziqet prioritare të pastrimit të parave për Kosovën. Procesi i gjetjes së fakteve dhe vlerësimit përfshin:

- Identifikimin e natyrës dhe vëllimit të çdo vepre përkatëse penale të përshkruar⁹ në Kosovë, për ta përcaktuar burimin e të ardhurave të paligjshme vendore.
- Identifikimin e natyrës dhe vëllimit të kërcënimeve të financimit të terrorizmit me të cilat përballet Kosova.
- Identifikimin e cenueshmërive në kuadër të sektorit financiar dhe sektorit jofinanciar. Këto vlerësime kanë marrë parasysh një numër faktorësh relevantë të rrezikut për llojet e subjekteve raportuese në kuadër të këtyre sektorëve, duke përfshirë edhe cenueshmëritë e tjera, siç janë:
 - Natyra, shkalla dhe kompleksiteti i llojeve të subjekteve raportuese individuale;
 - Produktet, shërbimet e kanaleve të shpërndarjes të ofruara nga llojet e subjekteve raportuese individuale;
 - Konsumatorët në kuadër të llojeve të subjekteve raportuese individuale;
 - Dhe efektiviteti i kontrolleve të PPP/LFT-së në kuadër të llojeve të subjekteve raportuese individuale për t'i reduktuar cenueshmëritë nga PP/FT-ja.

Kërcënimi i PP-së vlerësohet si i veçuar nga kërcënimi i FT-së. Megjithëse ka një mbivendosje, natyra e këtyre veprimtarive kriminale është e ndryshme, çka justifikon vlerësimet e ndara. Për dallim, vlerësimi i cenueshmërive nga PP/FT-ja nuk kërkon një ndarje të tillë, pasi që kërcënimet nga PP/FT-ja kërkojnë të shfrytëzojnë të njëjtin grup karakteristikash dhe tiparësh të cenueshme të produkteve dhe shërbimeve që ofrohen nga sektorët për t'i pastruar të ardhurat e krimit ose për ta financuar terrorizmin.

Vlerësimi i nivelit të kërcënimeve dhe cenueshmërive do të vlerësohet në përputhje me shkallën e mëposhtme:

- Jashtëzakonisht i ulët
- I ulët
- Mesatar
- I lartë
- Jashtëzakonisht i lartë

⁹ Secila nga veprat përkatëse penale vjen nga lista e FATF-së e kategorive të përcaktuara të veprave penale: <http://www.fatf-gafi.org/glossary/d-i/>

Kërcënimi nga pastrimi i parave

Ekspertët vlerësuan kërcënimet nga PP-ja nga krimet e orientuara drejt fitimit, veçanërisht për çështjet e mëposhtme:


- Madhësia e të ardhurave, duke përdorur një shkallë me pesë pikë
- Natyra e krimet
- Deri në çfarë mase po rritet ose po zvogëlohet tendenca e krimeve
- Deri në çfarë mase vijnë të ardhurat fillestare në para të gatshme, në asete financiare ose fizike
- Deri në çfarë mase lidhet krimi me krimin e organizuar apo krimin jo të organizuar
- Deri në çfarë mase mbahen paratë në Kosovë ose dërgohen në vende të tjera

Evazioni fiskal

Paraqet kërcënim **jashtëzakonisht të lartë** për pastrimin e parave

Evazioni fiskal është i përhapur, siç tregohet nga një studim i Bankës Botërore i vitit 2014, që arriti në përfundimin se boshllëku i TVSH-së është 34% (180 milion euro), boshllëku i tatimit mbi të ardhurat e korporatave është rreth 17% (10 milion euro) dhe i tatimit mbi të ardhurat personale është 66% (180 milion euro)¹⁰. Në mënyrë të ngjashme, një studim i vitit 2017 për ekonominë joformale konstatoi që boshllëku tatimor ishte më i madh se 300 milionë euro në vit¹¹.

Figura 5 Struktura tatimore e Kosovës (Përqindja e BPV-së)¹²



¹⁰ Banka Botërore. 2014. Të ardhurat e sektorit publik të Republikës së Kosovës: Politikat tatimore, evazioni fiskal dhe boshllëqet tatimore. <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/22269>

¹¹ Për më shumë informacion mbi ekonominë joformale, ju lutem shihni:

<https://www.bseurope.com/about-us/our-group/assessment-extent-informal-economy-kosovo>

¹² FMN Kosova AIV 2017, Statistikat e Financave të Qeverisë dhe llogaritjet e stafit të FMN-së

Evazoni fiskal në Kosovë është i përhapur dhe vjen në disa forma, megjithatë format kryesore të evazionit fiskal mund të lidhen me përhapjen e gjerë të informalitetit të ekonomisë (vlerësimet sugjerojnë se informaliteti është mbi 30% e ekonomisë), duke lejuar që të ardhurat nga puna dhe tregtia të mbeten të raportuara dhe për këtë arsye nuk taten. Sa i përket evazionit fiskal nga tatimi mbi të ardhurat personale, deri në një shkallë kjo është çështje e ndërlidhur strukturore, pasi sistemi tatimor i Kosovës nuk e përfshin dorëzimin e deklaratave individuale tatimore.

Nën-raportimi është gjithashtu një fenomen i zakonshëm në Kosovë, i cili në mënyrë të ngjashme mundësohet nga informaliteti i ekonomisë, dhe të ardhurat e raportuara tek autoritetet tatimore nuk pasqyrojnë të ardhurat aktuale, p.sh. kjo mund të lidhet me të ardhurat e fituara nga dhënia me qira e patundshmërive, ose kompanitë nuk japin informacion të saktë mbi të ardhurat që gjenerojnë: kjo shihet shpesh në ndërtimtari, bare dhe restorante, lojëra të fatit, në sektoret e shërbimeve profesionale (tarifat e avokatëve, mjekëve dhe konsulentëve).

Ka edhe raste të evazionit fiskal më të elaboruar, ku kompanitë prodhojnë fatura të rreme, për ta ulur në mënyrë të rrejshme shumën e tatimit të cilën duhet ta paguajnë. Megjithëse madhësia e këtij evazoni është e vogël në krahasim me ata të lartpërmendur, ende besohet të jetë në miliona euro.

Megjithatë evazoni fiskal zakonisht përfshin individë dhe kompani të zakonshme që përdorin teknika të evazionit fiskal me sofistikim të ulët, besohet se as pastrimi i parave që pason nuk është i sofistikuar. Në përgjithësi besohet se duke pasur parasysh se shumica e ekonomisë informale bazohet në para të gatshme, se shumica e të ardhurave marrin formën fillestare të parave të gatshme, nga të cilat një pjesë e rëndësishme mund të hyjë në sistemin financiar si depozita të thjeshta. Megjithatë, ka gjasa se që nga fillimi të ndodhin skema më të elaboruara të mashtrimit tatimor që i përfshijnë faturat mashtruese në kuadër të sistemit financiar. Besohet gjerësisht se shumica e të ardhurave nga evazoni fiskal mbeten brenda Kosovës, dhe nuk ka shenja se dërgimi i parave në korporatat ose bankat guacë apo në vendet e parajsave tatimore përbën një problem të rëndësishëm.

Tabela 1 Numri i rasteve të raportuara dhe i hetimeve për krimet tatimore

Rastet e raportuara						Hetimet		
2015		2016		2017		2015	2016	2017
Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona			
54	93	16	70	27	60	25	8	13

Burimi: Prokuroria

Tabela 2 Numri i rasteve të hetuara nga ATK

	2018	2019
Raste të hapura	30	37
Raporte të dyshimit fillestar / kallëzime penale	25	48
Raporte Finale Hetuese	29	24

Korrupsioni dhe ryshfeti

Paraqet kërcënim **jashtëzakonisht të lartë** për pastrimin e parave

Kosova, bazuar në Indeksin e Transparencës të vitit 2018, mori rezultatin 37/100 dhe pozicioni i saj në renditjen botërore është 93/180. Një nga arsyet kryesore të shqyrtuara nga Treguesi i Transparencës dhe që e përshkruan situatën në Kosovë është mungesa e transparencës në procesin e prokurimit publik.¹³

Një studim zbuloi se nëntë nga dhjetë kompani private kishin një kontakt të drejtpërdrejtë me një zyrtar publik. Takimi i drejtpërdrejtë është mënyra e preferuar për të paguar një ryshfet direkt në dorë, dhe kryesisht në para të gatshme. Një nga sektorët ekonomik më të cenueshëm është sektori i ndërtimit, në të cilin paguhen ryshfete për të marrë trajtim më të mirë gjatë procesit administrativ ose për një autorizim.¹⁴ Për pasojë, më shumë se 100 milionë euro shpërdorohen çdo vit për korrupsion, dhe 20% e të gjitha shumave të kontratave të lidhura çdo vit në Kosovë abuzohet nga zyrtarët publikë.¹⁵

Korrupsioni i vogël perceptohet në shumë shtete si korrupsion i zyrtarëve të vegjël ose të mesëm të lartë ose i personave zyrtarë që ndodh në kuadër të administratës publike në të cilën zyrtarët kryejnë shërbime publike. Në Kosovë, këtu përfshihen institucionet publike përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike në komuna, administrata tatimore, shërbimet shëndetësore, arsimit, shërbimet komunale dhe kadastrale. Përgjithësisht, besohet se shumica e PP-së të lidhur me këtë ka të ngjarë se merr formën fillestare të parave të gatshme dhe përdor skemën e thjeshtë të pastrimit të mundësuar nga madhësia e sektorit joformal.

Korrupsioni i madh zakonisht ndodh në pozicione të nivelit të lartë, si udhëheqës i divizionit ose departamentit në kuadër të një ministrie të caktuar, sekretarë të përhershëm dhe pozita të tjera të nivelit të lartë me ndikim në qeveri ose agjenci publike, ose gjyqtarë dhe prokurorë, por kryesisht i ndikon zyrat e prokurimit, doganat, zyrat tatimore, ose zyrtarë të tjerë në kuadër të institucioneve publike.

Teksa numri i rasteve të korrupsionit të vogël e tejkalon në masë të madhe korrupsionin e madh, besohet fuqishëm se të ardhurat e lidhura me korrupsionin e madh përbëjnë shumicën e të ardhurave nga korrupsioni në Kosovë. Konflikti i interesit dhe nepotizmi janë ndoshta

¹³ Treguesi, i cili i rendit 180 vende dhe terriore sipas niveleve të perceptuara të korrupsionit në sektorin publik sipas ekspertëve dhe afaristëve, përdor një shkallë prej 0 deri në 100, ku 0 është shumë i korruptuar dhe 100 është shumë i pastër. Për më shumë informacione shihni: www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2017

¹⁴ UNODC 2013, Biznesi, Korrupsioni dhe Krimi në Kosovë https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/Kosovo_Business_corruption_report_EN.pdf

¹⁵ Reshat Maliqi, (2016) Korrupsioni, Sfida për Institucionet e Kosovës http://journals.euser.org/files/articles/ejms_jan_apr_16_nr2/Reshat.pdf

problemet më të mëdha që lidhen me korrupsionin në Kosovë, por në përgjithësi nuk gjenerojnë të ardhura nga krimi në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Ndërkohë që korrupsioni në shkallë më të vogël mund të trajtohet në para të gatshme, korrupsioni në shkallë më të gjerë i lidhur me prokurimin, në përgjithësi përdor kompanitë e regjistruara (shih më shumë tek cenueshmëritë e personave juridik dhe aranzhimeve) të miqve, të cilët pastaj i kalojnë fondet në kompani të tjera në pronësi të bashkëpunëtorëve të tjerë ose të të afërmeve të personave të ekspozuar politikisht (PEP).¹⁶ Përdorimi i kompanive mbulesë e lehtëson shmangien e shqyrtimit të rreptë të bankave. Besohet se shumica e fondeve qëndrojnë brenda Kosovës, ndërsa kompanitë e patundshmërive dhe ndërtimit janë mjeti mbizotërues i përdorimit të fondeve.

Pavarësisht nga fakti se ka pasur disa përmirësime në treguesin e transparencës në tre vitet e fundit, përgjithësisht konsiderohet se kjo nuk e pasqyron madhësinë e të ardhurave nga korrupsioni, pasi korrupsioni i nivelit të lartë konsiderohet i qëndrueshëm ose madje edhe në rritje.

Tabela 3: Statistikat e veprave penale të “Korrupsionit”

Statistikat e veprave penale të “Korrupsionit”	2015	2016	2017	2018	2019
Kallëzime penale me kryes të njohur	67	160	134	131	136
Numri i personave të arrestuar	154	48	30	26	70
Numri i personave të përfshirë në kallëzime penale	340	320	253	237	341

Trafiku i drogës

Paraqet kërcënim **të lartë** për pastrimin e parave

Fitimet e shoqëruara me droga të paligjshme në Kosovë vijnë kryesisht nga opiatet dhe kanabisi, dhe në një shkallë më të ulët nga kokaina dhe stimuluesit e llojit të amfetaminës. Përdorimi i drogës nuk është i përhapur gjerësisht, megjithëse shihet se është rritur pak gjatë

¹⁶ PEP-të janë një kategori e veçantë e zyrtarëve të tanishëm ose të mëparshëm ndërkombëtarë, vendorë ose të huaj, që mbajnë ose kanë mbajtur një funksion të shquar dhe kanë kompetenca diskrecionare ose ndikim politik. Për më shumë informacione mbi PEP-të shihni http://fiu.rks-gov.net/wp-content/uploads/2018/06/PEPs-Typologies_ALB-SRB-ANG.pdf

viteve të fundit, dhe kjo me gjasë lidhet me rritjen e të ardhurave¹⁷. Kosova është vend tranziti për drogat e kontrabanduara për në tregjet e tjera evropiane, por shumica e drogave që kalojnë nëpër Kosovë nuk janë të shoqëruara nga transfertat e parave në Kosovë.¹⁸ Sipas perceptimeve, shumica e tregtisë së drogës (> 90%) kryhet në para të gatshme dhe shumica e fitimeve lidhen me krimin e organizuar.¹⁹

Tabela 4 Konfiskimet nga Policia e Kosovës gjatë viteve 2015-2019¹¹

	2015	2016	2017	2018	2019
<i>Marihuana</i>	462 kg 721.09 gr	1146 kg 949.4 gr	1908 kg 175.25 gr	979 kg ,794.63 gr	824 kg 230.2 gr 25 kg 447.16 gr hashash
<i>Opiatet</i>	9 kg 585.85 kg	84.55 gr	391.3 gr	119 kg 026.39 gr (heroin)	7 kg 717.9 gr heroine
<i>Kokaina</i>	54.5 kg	168.33 gr	711.65 gr	1 kg 718.77 gr	1 kg 581.68 gr
<i>Ekstazi</i>	265 tableta	0 tableta	141.24 gr	0,478.58 gr	110 hapa +131. 73 gr

Opiatet

Sasi të konsiderueshme të opiateve nga Afganistani kalojnë nëpër Turqi, nga ku kontrabandohen në Evropën Perëndimore përmes asaj që njihet si rruga e Ballkanit, dhe tregtia e opiateve në Kosovë ndjek këtë model. Disa grupe kriminale të organizuara nga Kosova punojnë në bashkëpunim me grupet e organizuara kriminale nga vendet e rajonit, por kryesisht janë identifikuar grupe më të vogla në lidhje me transportin e opiateve në Kosovë dhe nga Kosova për në vendet e Evropës Perëndimore. Shumica e drogave që kalojnë nëpër Kosovë nuk janë duke u tregtuar në vend, dhe perceptohet se ka shumë pak të ardhura që gjenerohen në Kosovë nga drogat e kontrabanduara përmes Kosovës²⁰.

UNODC vlerëson se nga shitja e paligjshme e opiateve për konsumin final nxirret fitimi bruto prej 12 milionë dollarësh amerikanë, dhe sipas natyrës së shitjes, pothuajse të gjitha të ardhurat duhet të gjenerohen në Kosovë.²¹

¹⁷ Mbledhje e Grupit Punues të ekspertëve të VRK-së 2018

¹⁸ Departamenti Amerikan i Shtetit 2016

<https://www.state.gov/j/inl/rls/nrcrpt/2016/vol1/253280.htm>

¹⁹ Mbledhje e Grupit Punues të ekspertëve të VRK-së 2018

[1] Informacion nga Policia e Kosovës

²⁰ Policia e Kosovës, 2016 Vlerësimi i Kërcënimit të Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar

[http://www.kosovopolice.com/repository/docs/SERIOUS AND ORGANISED CRIME THREAT ASSESSMENT - SOCTA, 2014-2015.pdf](http://www.kosovopolice.com/repository/docs/SERIOUS_AND_ORGANISED_CRIME_THREAT_ASSESSMENT_SOCTA_2014-2015.pdf)

²¹ https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/Studies/IFF_report_2015_final_web.pdf

Marihuana

Sasitë më të mëdha të marihuanës hyjnë në Kosovë nga Shqipëria, ndërsa sasi më të vogla vijnë edhe Maqedonia Veriore, Serbia dhe Mali i Zi. Një pjesë e sasisë së marihuanës mbahet në Kosovë për konsum të brendshëm, ndërsa pjesa tjetër, e cila konsiderohet disa herë më e madhe në sasi, kalon tranzit në vende të tjera, kryesisht për në tregjet e Evropës Perëndimore. Sikur me opiatet, marihuana që kalon nëpër Kosovë nuk konsiderohet të gjenerojë shumë të ardhura në Kosovë.²²

Marihuana është drogë shumë më e përdorur, megjithatë, duke pasur parasysh çmimin shumë më të ulët në krahasim me opiatet, nuk është e qartë se cili prej tyre gjeneron më shumë të ardhura. Perceptohet se pjesë e rëndësishme të të ardhurave nga marihuana kthehet në vendet e origjinës.²³ UNODC vlerëson se një kilogram marihuanë shitet për 600-900 euro, ndërsa një dozë prej 5 gramësh shitet për 20-25 euro²⁴.

Kokaina

Edhe pse kokaina është një prej drogave më të njohura në Kosovë për vite me radhë, prania e saj në tregun e brendshëm është relativisht e ulët, dhe nuk konsiderohet se gjeneron të ardhura që mund t'i afrohen përmasave të kanabisit dhe opiateve. Në përgjithësi, kokaina e konfiskuar në Kosovë gjendet në sasi të vogla dhe kryesisht tek individë që e përdorin ose e shesin²⁵.

Falsifikimi dhe pirateria e produkteve

Paraqet kërcënim të lartë për pastrimin e parave

Dëshmitë sugjerojnë se ka pak prodhim vendas të mallrave të falsifikuara në Kosovë, por është shqetësues importimi i mallrave të falsifikuara, veçanërisht i veshmbathjeve dhe në një shkallë më të vogël i mallrave elektronike. Prevalenca e produkteve të falsifikuara dhe pirate në Kosovë është rritur ndjeshëm gjatë dekadës së kaluar, në sasi dhe gamë të produkteve në dispozicion për shitje, dhe ka arritur një shkallë ku tregjet dhe shitoret më të vogla të shitjes me pakicë shihen shpesh të tregtojnë haptazi mallra të falsifikuara. Kina është burimi kryesor i produkteve të falsifikuara të importuara në Kosovë²⁶. Masat mbrojtëse të të drejtave të pronës intelektuale po përmirësohen ngadalë, por kufizohen nga mungesa e vazhdueshme e ndërjegjësimit në sistemin publik dhe gjyqësor.²⁷

²² Policia e Kosovës, 2016 Vlerësimi i Kërcënimit të Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar

²³ Mbledhja e Grupit Punues të ekspertëve të VRK-së 2018

²⁴ Të dhënat e UNODC, 2018 <https://www.unodc.org/unodc/en/data-and-analysis/statistics/drug-trafficking.html>

²⁵ Policia e Kosovës, 2016 Vlerësimi i Kërcënimit të Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar

²⁶ Mbledhja e Grupit Punues të ekspertëve të VRK-së 2018

²⁷ Policia e Kosovës, 2016, Vlerësimi i Kërcënimit të Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar

Autoritetet gjurmojnë dhe raportojnë për konfiskimet e mallrave të falsifikuara. Në vitin 2016, Dogana konfiskoi mallra të falsifikuara me vlerë mbi 2.5 milionë euro. Ndërkohë që shitja përfundimtare, në nivel të shitjes me pakicë, në përgjithësi do të bëhet me para të gatshme²⁸, tregtia ndërkombëtare në nivel të shumicës, sipas natyrës së tregtisë, do të zhvillohet pothuajse ekskluzivisht nëpërmjet sistemit financiar, me Kinën si vendin kryesor rezervues.

Tabela 5: Numri i rasteve të raportuara

2015		2016		2017	
Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
9	27	4	7	8	23

Kontrabanda

Paraqet kërcënim **të lartë** për pastrimin e parave

Ky krim, ashtu si i gjithë trafikimi i paligjshëm, mundësohet nga kufiri poroz i Kosovës me vendet përreth. Kontrabanda e mallrave nga Serbia në Kosovë mbetet në qendër të vëmendjes së grupeve kriminale, dhe produktet e Serbisë janë shumë të pranishme në tregun e brendshëm, me çmime konkurruese. Mallrat kontrabandë janë kryesisht produkte të karburantit, barna farmaceutike, produkte qumështi, pemë, produkte të mishit, cigare, kafe, pije alkoolike, perime, mjete bujqësore, pajisje elektronike, tekstile²⁹.

Kontrabanda kryesore në mes të Kosovës dhe Serbisë bëhet në pjesën veriore të Kosovës, por është problem edhe në rajonin e Gjilanit. Kontrabandistët përdorin automjete të ndryshme transportuese si kamionë, makina, traktorë, kombi dhe linja të rregullta autobusi.³⁰

Duhani konsiderohet një produkt i rëndësishëm i kontrabandës në Kosovë, me vendet e burimit që janë kryesisht Mali i Zi dhe Shqipëria. Kontrabanda e duhanit konsiderohet se ka rënë³¹.

Shumica e transaksioneve që kanë të bëjnë me kontrabandën bëhen në para të gatshme, dhe konsiderohet se shumica e parave kthehen në vendin e origjinës së produkteve.

Tabela 6: Numri i rasteve të hetuara nga Doganat

2015	2016	2017	2018	2019
57	65	61	60	128

²⁸ Ndonjë shitore e vogël me pakicë mund të pranojë pagesa me kartela të debitit/kreditit

²⁹ Policia e Kosovës 2016, Vlerësimi i Kërcënimit të Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar

³⁰ Policia e Kosovës 2016, Vlerësimi i Kërcënimit të Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar

³¹ Mbledhje e Grupit Punues të ekspertëve të VRK-së 2018


Trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabanda e emigrantëve

Paraqet kërcënim **të lartë** për pastrimin e parave

Trafikimi i qenieve njerëzore

Departamenti Amerikan i Shtetit, në raportin e vitit 2018 për trafikimin e qenieve njerëzore, e klasifikon Kosovën si Niveli 2, çka do të thotë se vendi nuk përmbush plotësisht standardin ndërkombëtar në luftimin e këtij krimi, por qeveria dhe agjencitë e zbatimit të ligjit po merren me problemin në mënyrë aktive.³²

Figura 6 Forma e shfrytëzimit të viktimave të trafikimit 2012-2015



Trafikimi i qenieve njerëzore është kryesisht i lidhur me shfrytëzimin seksual, me 80% të viktimave dhe një pjesë të supozuar edhe më të lartë të të ardhurave nga trafikimi i qenieve njerëzore që vjen nga shfrytëzimi seksual. Shumica e viktimave të kësaj tregtie janë gra që vijnë nga Evropa Lindore, veçanërisht Shqipëria, Moldavia, Bullgaria, Rusia dhe Ukraina. Moshë mesatare e viktimave është mes 20 dhe 35 vjeç; ato janë kryesisht gra të rekrutuara në vendlindjen e tyre me shpresën për një punë dhe jetë më të mirë në Evropë. Në vitet e fundit, statistikët e policisë nënvizojnë një shtim të rasteve të hetuara për trafikim me qenie njerëzore, si dhe një shtim të fëmijëve viktimë të krimit³³.

Konsiderohet se trafikimi i qenieve njerëzore për shfrytëzim seksual ka lidhje shumë më të forta me krimin e organizuar për prostitucionin që përshkruhet më poshtë, veçanërisht me krimin e organizuar ndërkombëtar, duke qenë se shumica e vajzave rekrutohen jashtë vendit. Pothuajse

³² <https://www.state.gov/reports/2018-trafficking-in-persons-report>

³³ Policia e Kosovës 2016, Vlerësimi i Kërcënimit të Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar

të gjitha të ardhurat marrin formën fillestare të parave të gatshme, me pjesë të rëndësishme të të ardhurave që mund të kthehen në vendin e origjinës së grupit të krimit të organizuar. Në masën që lokalet e masazhit dhe hotelet që lidhen me shfrytëzimin seksual janë të lidhura me sistemet financiare, ka të ngjarë që disa të ardhura të hyjnë në sistemin financiar në Kosovë.

Tabela 7: Numri i kallëzimeve penale dhe i personave të dyshuara

Kallëzimet Penale të dorëzuara ne Prokurori sipas veprave	2018	2019
Trafikim me njerëz	12	21
Numri i personave ndaj të cilëve është ngritur kallëzim penal - sipas v. penale	2018	2019
Trafikim me njerëz	22	37

Kontrabanda e emigrantëve

Kontrabanda ndërkombëtare e emigrantëve që kalojnë përmes Kosovës ka qenë në rënie të fuqishme në vitet e fundit, sidomos në lidhje me personat me origjinë siriane dhe afgane. Emigrantët e kontrabanduar ilegalisht përmes të të ashtuquajturave "Rrugë Ballkanike", vijnë nga kufijtë jugorë me Maqedoninë Veriore dhe e vazhdojnë udhëtimin e tyre drejt Evropës, përmes Serbisë ose nga portet e Shqipërisë. Sidoqoftë, shumë pak nga të ardhurat konsiderohet të jenë të lidhura me Kosovën, pasi pagesat që përgjithësisht lidhen me kontrabandimin e emigrantëve bëhen në vende të tjera.

Migrimi i kategorive të caktuara të qytetarëve të Kosovës drejt vendeve të Evropës Perëndimore është një fenomen aktual. Emigrantët janë kryesisht njerëz në kushte të vështira ekonomike, të papunë ose të punësuar kryesisht në sektorin privat, me paga të ulëta ose mesatare, me ndihmë sociale, disa me çështje të pazgjidhura të strehimit, të pakënaqur me shëndetësinë, pensionet, sigurinë, politikat arsimore etj. Megjithatë, konsiderohet se nuk ka shumë të ardhura nga krimi të lidhura me këtë vepër, duke pasur parasysh kufirin relativisht poroz të Kosovës (shih gjithashtu pjesën për falsifikimin në lidhje me pasaportat e falsifikuara).

Tabela 8: Numri i rasteve të raportuara dhe i personave të dyshuara për kontrabandim me migrant

Rastet e raportuara					Nr. i te dyshuarve				
2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019
17	3	10	8	5	13	8	16	5	9

Prostitucioni

Paraqet kërcënim **të lartë** për pastrimin e parave

Prostitucioni është i paligjshëm në Kosovë³⁴ dhe vepron me disa mbivendosje me trafikimin e qenieve njerëzore (shih më shumë informacione më lart), me dallimin se trafikimi i qenieve njerëzore përfshin mjete kërcënimi ose përdorim të forcës apo formave të tjera të detyrimit, ndërkohë që këtu, me prostitucion referohen angazhimet vullnetare. Në vitet e fundit ka pasur një rritje të numrit të lokaleve të masazhit që kanë të ngjarë të kenë lidhje me prostitucionin,³⁵ dhe teksa ekzistojnë disa mangësi të inteligjencës në lidhje me shtrirjen dhe shkallën e plotë të prostitucionit në Kosovë, supozohet se prostitucioni po rritet.

Prostitucioni dihet se gjeneron shuma të konsiderueshme parash (rreth 30-50 euro për klient), pothuajse ekskluzivisht në para të gatshme. Shumica e vazave që punojnë nuk janë kosovare, por nga vende si Bullgaria, Rumania, Moldavia, prandaj pritet që shumica e parave të gjeneruara në fund të fundit të transferohen jashtë vendit.

Mashtrimi

Paraqet kërcënim **mesatar** për pastrimin e parave

Mashtrimi paraqitet në shumë forma në Kosovë, megjithatë mashtrimet në shkallë të gjerë me produkte financiare dhe investuese siç janë skemat e mëdha piramidale, nuk duket se janë një kërcënim i rëndësishëm në Kosovë deri më sot. Kjo ka të ngjarë të jetë e lidhur deri diku me nivelin relativisht të ulët të produkteve të investimeve të sofistikuara të ofruara nga sistemi financiar në Kosovë.

Klonimi i kartelave të kreditit është lloji më i shpeshtë i mashtrimit në Kosovë, edhe pse nuk konsiderohet si problem i përhapur, ndërkohë që perceptohet se të ardhurat nga ky lloj mashtrimi largohen nga Kosova nëpërmjet transfertave elektronike. Mashtrimet që lidhen me mashtrimet me email, të tilla si mashtrimet me email të nigerianëve, si në shumë vende, janë faktor edhe në Kosovë. Ka pasur një rritje të kohëve të fundit në rastet e mashtrimit nga agjencitë turistike, ku janë shitur bileta dhe paketa mashtruese të pushimeve. Në Kosovë ka gjasa të ndodhë edhe keqpërdorimi me përfitimet shtetërore, ku njerëzit me mashtrim marrin përfitime që nuk u takojnë.

Rastet e mashtrimit në Kosovë janë përgjithësisht të lidhura me krimin e organizuar ndërkombëtar, me pagesat që kryesisht bëhen me asete financiare, dhe në krahasim me

³⁴ Kodi Penal i Kosovës

³⁵ Disa hotele/motele gjithashtu dyshohet se kanë lidhje të forta me prostitucionin

shumicën e llojeve të tjera të krimit në Kosovë, shfaqin nivele shumë të larta të sofistikimit dhe të aftësive në lidhje me pastrimin e të ardhurave të lidhura me mashtrimin.

Tabela 9: Numri i rasteve të raportuara , hetimeve dhe i personave të dënuar

Rastet e raportuara						Hetimet			Personat e dënuar		
2015		2016		2017		2015	2016	2017	2015	2016	2017
Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona	17	20	18	80	140	88
412	860	438	849	402	668						

Burimi: KPK

Tabela 10: Statistikat e veprave penale të “Mashtrim”

Statistikat e veprave penale të “Mashtrim”	2015	2016	2017	2018	2019
Kallëzime penale me kryes të njohur	14	19	15	24	23
Numri i personave të arrestuar	1	15	13	2	19
Numri i personave të përfshirë në kallëzime penale	18	33	32	35	64

Zhvatja dhe fajdet

Paraqet kërcënim **mesatar** për pastrimin e parave

Në Kosovë janë zbuluar disa raste të fajdeve, ku individët kanë marrë hua dhe u është kërkuar t'i paguajnë kreditë me interes në rritje, dhe teksa informacioni i bazuar në rastet e raportuara nuk është gjerësisht i përhapur, besohet se shumë raste nuk raportohen, pasi që personat të cilët marrin para përmes fajdeve hezitojnë ta raportojnë krimin.

Fajdet lidhen në përgjithësi me individët që nuk mund të marrin kredi nëpërmjet sistemit financiar³⁶ ose kanë nevojë urgjente për para. Fajdexhinjtë u japin para personave të ndryshëm, duke e shfrytëzuar gjendjen e tyre të dobët ekonomike dhe gjykimin e tyre të gabuar për

³⁶ Kjo ndodh pavarësisht faktit se Kosova ka nivel të mirë të përfshirjes financiare <http://datatopics.worldbank.org/financialinclusion/country/kosovo>

gjendjen e tyre materiale.³⁷ Nuk ka pasur shenja të grupeve të organizuara dhe të strukturuar kriminale të identifikuara deri tani, por vetëm individë dhe grupe të vogla kriminale.

Zhvatja nuk është një fenomen i zakonshëm në Kosovë, dhe kompanitë nuk përballen me kërcënime të mëdha të zhvatjes. Në Kosovë, përveç që kryesisht lidhet me fajdet, zhvatja manifestohet përmes kërcënimeve, shantazheve³⁸, dhe shumica e rasteve të raportuara janë kryesisht raste të vogla ose individuale, ku kriminelit takohet personalisht me viktimat për t'i kërcënuar ose për t'i marrë paratë. Kërcënimet rrallë bëhen me telefon.³⁹

Pagesat si në rastet e zhvatjes ashtu edhe të fajdeve zakonisht bëhen në para të gatshme, dhe pjesa dërrmuese e tyre ka gjasa të mbetet brenda Kosovës.

Tabela 11 Numri i rasteve të fajdeve nga viti 2015 deri në vitin 2019

	2015	2016	2017	2018	2019
Fajde	25	13	28	19	20

Grabitja ose vjedhja

Paraqet kërcënim **mesatar** për pastrimin e parave

Krimet e rrugës (vjedhja, grabitja e çantave) nuk shihen si problem i zakonshëm në Kosovë dhe nuk shfaqen si shqetësim i përgjithshëm në jetën e përditshme. Në përgjithësi, njerëzit nuk mbajnë më sasi të mëdha parash në shtëpi, gjë që i ka ulur të ardhurat nga vjedhjet në shtëpitë e njerëzve. Ka raste të vjedhjes së makinave, por janë në rënie, dhe makinat e vjedhura zakonisht përdoren si pjesë.

Ka raste të institucioneve private, si markete ose pompa të benzinës që janë shënjestër e vjedhjeve, por në përgjithësi vlerat e vjedhura nuk janë të mëdha. Ka megjithatë disa shenja të grabitjeve më të shpeshta dhe të dhunshme të institucioneve financiare. Në përgjithësi të ardhurat nga grabitja dhe vjedhja konsiderohen të jenë në vlera më të ulëta të miliona eurove.

³⁷ <http://www.kosovopolic.com/en/informations/kosovo-police-continues-with-police-activities-with-the-aim-of-combating-and-prevention-various-criminal-activities-including-prevention-of-usuries-and-extortion>

³⁸ Policia e Kosovës 2016, Vlerësimi i Kërcënimit të Krimeve të Rënda dhe Krimin të Organizuar

³⁹ https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/corruption/Kosovo_Business_corruption_report_EN.pdf

Krimet Kibernetike

Paraqet kërcënim **mesatar** për pastrimin e parave

Zhvillimi i hovshëm teknologjisë informative ka ndikuar edhe në paraqitjen e veprave të reja penale të ashtuquajtura krimet kibernetike të cilat kanë marrë hov viteve të fundit.

Ndërhyrja në sistemet kompjuterike bankare duke kryer transaksione të kundërligjshme për përfitime personale, ndërhyrje në të dhënat personale dhe faqe zyrtare të cilat shpesh herë përveç që cenojnë të drejtat themelore të njeriut këto ndërhyrje mund të paraqesin edhe kërcënim për institucionet e sigurisë. Pastaj nga ndërhyrjet në sistemet e institucioneve të sigurisë mund të zbulohet të dhëna sekrete që paraqesin kërcënim për sigurinë kombëtare.

Rritja e konsiderueshme e numrit të shfrytëzuesve të internetit në vitet e fundit në Kosovë ka sjellë me vete rrezikun e rritur të krimit dhe të sulmeve kibernetike.

Sipas të dhënave në dispozicion, shënjestra kryesore e sulmeve kibernetike në Kosovë deri më sot kanë qenë llogaritë e shfrytëzuesve, sistemi bankar, dhe ueb faqet në Internet.

Krimi kibernetikë përbëhet nga vepra penale që kryhen në rrjete, me anë të rrjeteve elektronike të komunikimit dhe informimit. Ky është problem i pakufishëm, që mund të klasifikohet në tri definicione më të gjera: Krimet specifike të Internetit, si sulmet ndaj sistemeve informative apo fishing p.sh. faqe të rreme bankare për të marrë fjalëkalime që mundësojnë qasje në llogari bankare të viktimave. Mashtrime dhe falsifikime kibernetike: vjedhja e identitetit, posta e padëshiruar, klonimi i kartelave bankare dhe kartelave tjera, kodimet keqdashëse. Përmbytja e paligjshme online, duke përfshirë materialet me keqpërdorim seksual të fëmijëve, nxitjen e urrejtjes racore, nxitjen e akteve terroriste dhe idealizimin e dhunës, terrorizmit, racizmit dhe ksenofobisë⁴⁰.

Rastet që janë trajtuar nga Agjensionet e Zbatimit të Ligjit në Kosovë janë:

- Keqpërdorimi i fëmijëve përmes internetit (pornografia e fëmijëve në internet);
- Hyrje e paautorizuar në sistem kompjuterik (sulme DDoS, vjedhje e fjalëkalimeve, sulme në ueb-faqe qeveritare, të institucioneve të ndryshme publike, kompani biznesi etj.);
- Kërcënime dhe shantazhe përmes e-mail-it (përfshirë edhe ndaj personaliteteve të rëndësishme publike dhe institucioneve);
- Lajm i rrejshëm (përmes e-mail-it të falsifikuar);

Sipas Policisë së Kosovës, rastet e sulmeve kibernetike kanë të bëjnë me hyrje në sisteme kompjuterike, keqpërdorim të kartelave dhe pornografi përmes internetit⁴¹.

⁴⁰ Rastet e krimit kibernetik / Trendet - SOCTA Report

⁴¹ <https://www.gazetaexpress.com/lajme-krimet-kibernetike-ne-rritje-ne-kosove-policia-tregon-sa-persona-ka-arrestuar-588890/>

Tabela 12: Statistikat e rasteve të krimeve kibernetike për periudhën 2015-2019:

	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019
Rastet	18	24	34	40	42	43	46
Persona të arrestuar	11	7	11	4	26	13	20
Kallëzime Penale	5	9	8	14	24	24	16
Asistime	55	80	118	152	199	210	262

Krimi mjedisor

Paraqet kërcënim të ulët për pastrimin e parave

Ndërtimet pa asnjë kriter, teknologjitë e vjetëruara, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, menaxhimi i dobët i deponive industriale dhe shtëpiake dhe shfrytëzimi i egër i resurseve natyrore, paraqesin probleme të mëdha mjedisore në vend⁴². Ndotja e ajrit në zonat urbane dhe sidomos në zonat industriale vlerësohet të jetë e lartë. Niveli i lartë i varfërisë dhe ekonomia joformale po bëjnë presion shtesë mbi tokën, domethënë po e kërcënojnë kapacitetin e tokës "ekonomike dhe mjedisore"⁴³. Teksa këto çështje mjedisore janë me të vërtetë serioze, ato nuk gjenerojnë drejtpërdrejt përfitime që pastrohen.

Prerjet e paligjshme kryhen në shumë forma në Kosovë, duke përfshirë prerjet pa leje nga pyjet publike, prerjet në zonat e mbrojtura, deklarimi i rremë i vëllimit të drurit të prerë dhe prerjet e paligjshme nga pyjet private: Kontrabanda dhe praktikrat e paligjshme të kontabilitetit e zgjerojnë listën edhe më tej⁴⁴. Prerjet e paligjshme kanë edhe një dimension transnacional, dhe mungesa e kapaciteteve për t'i mbrojtur pyjet në Kosovë do të thotë se pyjet publike dhe private, në veçanti në kufi/vijë kufitare, janë të cenueshme dhe një objektiv kryesor i vjedhësve të drurit⁴⁵.

Megjithatë, ka pasur një rënie të fortë në prerjet e paligjshme më sistematike, pasi shumica e drunjve tashmë janë prerë, dhe krimi nuk ka më lidhje të konsiderueshme me krimin e organizuar në Kosovë. Pjesa më e madhe e atyre që mbeten janë individët që presin dru në mënyrë të paligjshme për shkak të situatave të dobëta ekonomike, kryesisht për furnizimin e tyre ose për t'i rishitur me qëllim të blerjes për nevojat themelore. Prandaj, aktualisht nuk

⁴² Strategy_for_Environment_Protection_2013-2022; https://mmph.rks.gov.net/repository/docs/Strategy_for_Environment_Protection_2013-2022_English_language_62392.pdf

⁴³ Po aty

⁴⁴ Lajmet e EULEX, 2012

⁴⁵ Raporti për Botën më të Sigurt (2011), Hartimi i kufijve në Ballkanin Perëndimor, 2011

konsiderohet një burim i rëndësishëm për të ardhurat e krimit. Duke pasur parasysh natyrën e krimit, të ardhurat do të marrin formën e aseteve fizike (d.m.th. dru) dhe për aq sa shitet, në përgjithësi do të shndërrohet në para të gatshme.

Në historinë e kohëve të fundit ka pasur raste të mihjes së paligjshme dhe hedhjes së paligjshme të mbeturinave, p.sh. në shtretërit e lumenjve, megjithatë ky nuk shihet aktualisht si kërcënim i rëndësishëm dhe nuk ka të ngjarë që aktualisht të gjenerojë të ardhura të vlefshme.

Tregtia e paligjshme e armëve

Paraqet kërcënim **të ulët** për pastrimin e parave

Tregtia e paligjshme e armëve në Kosovë nuk konsiderohet një krim madhor në krahasim me kontrabandimin e qenieve njerëzore apo mallrave të tjera. Nuk ka pasur kërkesa për armë të vogla dhe municione të reja, duke marrë parasysh sasinë e armëve dhe municioneve të disponueshme nga konflikti i armatosur i kohëve të fundit. Tregu kriminal për blerjen e armëve të paligjshme konsiderohet të jetë i vogël. Përveç kërkesës relativisht të ulët, edhe çmimi mesatar konsiderohet të jetë i ulët (më pak se disa qindra euro për armë).

Trendi i fundit janë armët me gaz, që janë të paligjshme në Kosovë, por mund të blihen ligjërisht në disa nga vendet fqinje, dhe pastaj kontrabandohen në Kosovë, megjithatë kjo lidhet me pastrimin e parave vetëm deri në shkallën që këto rishiten në Kosovë.

Njësitë e policisë të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë kanë kapur rreth 239 armë dhe 2584 lloje të ndryshme municionesh gjatë gjashtë muajve të parë të vitit 2018.⁴⁶

Tabela 13: Numri i rasteve të raportuara dhe i armëve të sekuestruara (përfshirë municione)

Rastet e raportuara					Artikujt e sekuestruar				
2015	2016	2017	2018	2019	2015	2016	2017	2018	2019
2	4	3	12	9	12 arme	10 arme	3 arme + granata dore	48 arme	176 arme
					42 fishek	263 fishek	9 fishek	5432 fishek	10350 fishek
						12.4 kg TNT			

⁴⁶ Raporti i Policisë së Kosovës (2017)

http://www.kosovopolicice.com/repository/docs/RAPORTI_ANGLISHT_2017.pdf

Falsifikimi

Paraqet kërcënim **jashtëzakonisht të ulët** për pastrimin e parave

Falsifikimi në Kosovë është kryesisht një krim që lidhet me kontrabandimin e emigrantëve, me vizat dhe pasaportat e falsifikuara të nevojshme për ta kaluar kufirin, sidomos në vendet evropiane të Shengenit. Në përgjithësi, konsiderohet si krim i organizuar, pasi që kërkohet një sasi e konsiderueshme e ekspertizës teknike për t'i falsifikuar bindshëm pasaportat evropiane - diçka që nuk mund të bëhet pa një organizim të duhur logjistik.

Çmimi i një pasaporte të BE-së ishte midis 1000-4000 dollarëve amerikanë,⁴⁷ por mund të ketë rënë për shkak të rritjes së emigracionit të paligjshëm në Evropë⁴⁸. Edhe pse në vitin 2015 gjatë një operacioni policor u zbuluar një punëtori e specializuar për falsifikimin e pasaportave evropiane në Kosovë,⁴⁹ në përgjithësi konsiderohet se shumica dërrmuese e pasaportave të rreme evropiane në Kosovë janë prodhuar dhe shitur jashtë Kosovës, prandaj janë të pakta fitimet që shoqërohen me këtë krim në Kosovë.

Tabela 14: Statistikat e veprave penale të "Falsifikimit"

Statistikat e veprave penale të "Falsifikimit"	2015	2016	2017	2018	2019
Kallëzime penale me kryes të njohur	71	64	88	70	152
Numri i personave të arrestuar	8	10	38	22	33
Numri i personave të përfshirë në kallëzime penale	90	87	129	111	371

Falsifikimi i monedhës

Paraqet kërcënim **jashtëzakonisht të ulët** për pastrimin e parave

Pavarësisht se në vitin 2017 doganat e Kosovës konfiskuan mbi 2 milion euro të falsifikuara në pikëkalimin kufitar në Vermicë (pika kufitare me Shqipërinë), monedha e falsifikuar nuk është

⁴⁷ <https://www.vocativ.com/news/241487/fake-passport-prices-black-market/index.html>

⁴⁸ <https://www.express.co.uk/news/world/750525/Fake-passport-cost-slashed-Migrant-UK-Europe-Document-renting>

⁴⁹ <https://ca.reuters.com/article/topNews/idCAKBN0TT29M20151210>

një problem i përgjithshëm dhe zakonisht kryhet nga individë oportunistë që prodhojnë produkte me cilësi të ulët që nuk gjenerojnë shumë fitim (nëse ka të tillë).

Tabela 15: Euro të falsifikuara që janë konfiskuar

	500 euro	200 euro	100 euro	50 euro	20 euro	10 euro	5 euro
2015	4	23	65	273	122	53	17
2016	9	17	95	429	184	67	23
2017	8	5	716	526	207	53	42
2018	16	199	556	495	79	79	9

Trafikimi i paligjshëm në mallra të vjedhura dhe të tjera

Paraqet kërcënim **jashtëzakonisht të ulët** për pastrimin e parave

Ky nuk është një krim që gjeneron të ardhura të rëndësishme në Kosovë; ka dy lloje mallrash që mund të gjenerojnë të ardhura të konsiderueshme: 1) makinat e vjedhura dhe 2) shitja e objekteve të lashta. Vjedhja e makinave në Kosovë është e ulët dhe është në rënie. Makinat që vidhen në përgjithësi shpërndahen dhe pastaj rishiten për pjesë brenda Kosovës. Vlera monetare e objekteve të lashta në Kosovë në përgjithësi konsiderohet shumë e ulët dhe nuk ka prova për ekzistencën e një tregu kriminal për to⁵⁰.

Tabela 16: Numri i rasteve të raportuara dhe i personave të dënuar

Rastet e raportuara						Numri i personave të dënuar		
2015		2016		2017		2015	2016	2017
Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona			
13	19	14	25	4	6	3	1	-

⁵⁰ Mbledhja e Grupit Punues të ekspertëve të VRK-së 2018

Të ardhurat ndërkombëtare të flukseve të krimit

Flukset hyrëse

Kosova, nga perspektiva ndërkombëtare, nuk është një qendër e madhe financiare dhe në përgjithësi nuk konsiderohet të jetë veçanërisht e ekspozuar ndaj të ardhurave të paligjshme nga njerëzit që nuk kanë lidhje direkte me Kosovën. Bazuar në bashkëpunimin ndërkombëtar mes NJIF-ve, autoritetet e Kosovës kanë ngrirë dhe sekuestruar rreth 1 milion euro. Tipologjia si në vijim: *pas pranimit të një STR-je nga një subjekt raportues, NJIF-K ka analizuar dhe identifikuar që përmbajtja e raportit përfshin gjithashtu shtetasit e huaj nga një vend i Bashkimit Europian. Të dhënat nga burimet e hapura tregojnë për përfshirje të në aktivitete ilegale të personave të involvuar në vendin e origjinës. Menjëherë NJIF-K ka parashtruar kërkesë në njësinë homologe të huaj dhe bazuar në përgjigjen e tyre dhe analizave të kryera, NJIF-K ka lëshuar një urdhër për ngrirje të transaksionit në një shumë të konsiderueshme rreth 1 milion euro. Me këtë rast NJIF-K ka dërguar raport spontan në vendin e BE dhe ka shpërndarë raport për Prokurorinë Speciale rreth ngrirjes së fondeve.*

Ndërkohë, lëvizja ndërkombëtare e fondeve ishte identifikuar me më tepër se 15 vende tjera të botës, në të cilat NJIF-K ka dërgu kërkesë dhe në shumicën e këtyre vendeve janë pranuar përgjigjet që për të njëjtit janë pranuar raporte të transaksioneve të dyshimta në ato vende gjithashtu.

Përveç kësaj, pas një periudhe të shkurtër, NJIF-K dhe autoritetet kompetente kanë pranuar një kërkesë nga vendi i BE për ndihmë juridike ndërkombëtare në këtë fushë dhe masat e sekuestrimit.

Gjykata ka vendos për konfiskimin e mjeteve të sekuestruara dhe dy persona janë dënuar me burg për veprën "pastrim i parave".

Remitancat janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për të paktën 43 për qind të popullsisë së Kosovës, gjë që përfaqëson rreth 15 për qind të BPV-së (ose gati 1 miliard euro) në vitin 2017. Shumica e remitancave vijnë nga diaspora e Kosovës në vendet evropiane, veçanërisht në Gjermani dhe Zvicër⁵¹. Përderisa shumica dërrmuese e remitancave përfitohen nga aktivitetet e ligjshme, shkalla në të cilën diaspora mund të gjenerojë të ardhura nga krimi i mundshëm në vendin e tyre pritës, potencialisht ka të ngjarë të reflektohet në hyrjen e remitancave në Kosovë.

⁵¹ Për më shumë informacione shihni:

<http://www.worldbank.org/en/topic/migrationremittancesdiasporaissues/brief/migration-remittances-data>

Përveç kësaj, Kosova është ekonomi e hapur, ku shumica e tregtisë zhvillohet me vendet e saj fqinje, dhe ashtu si biznesi i ligjshëm, të ardhurat e krimit nga vendet fqinje ka të ngjarë të kalojnë në Kosovë.

Transfertat e të ardhurave të paligjshme në Kosovë ka të ngjarë ta ndjekin modelin e remitancave dhe të tregtisë, ku shumica dërrmuese shkojnë nëpërmjet sektorit bankar. Agjentët e transfertave të parave dhe kontrabanda e thjeshtë e parave të gatshme konsiderohen se e mbulojnë shumicën e të ardhurave të paligjshme që vijnë në Kosovë.

Tabla 17: Kërkesat që vijnë nga NJIF të huaja për NJIF-K

Kërkesat e FIU-ve të huaja të dërguara në NJIF-K	2016	2017	2018
Albania	2	4	7
Austria	-	-	1
Bulgaria	1	-	-
Belgium	-	1	3
Croatia	-	1	-
Denmark	-	1	1
Ecuador	-	1	-
Finland	1	-	-
Germany	-	1	3
Italy	-	-	1
Philippines	-	2	-
Jordan	-	1	-
Hungary	-	2	-
Montenegro	3	1	1
The Netherlands	1	4	1
North Macedonia	3	2	2
Norway	3	-	2
Poland	-	2	-
Slovenia	-	1	-
Paraguay	-	-	1
Switzerland	2	5	1
FIU tjerë	-	4	7
Gjithsej	16	33	31

Tabela 18: Kërkesat që vijnë për ndihmë të ndërsjellë juridike dhe kërkesat e marra për ekstradim

	2014		2015		2016		2017		2018	
	NNJ	Ekstradim	NNJ	Ekstradim	NNJ	Ekstradim	NNJ	Ekstradim	NNJ	Ekstradim
Pastrimi i parave	1		5		1		4			
Pjesëmarrja në një grup të organizuar kriminal dhe aktivitete të paligjshme	6	1	1	1	5		1		4	4
Trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabandimi i emigrantëve	8	1	9		9	1	9		7	1
Shfrytëzimi seksual	3		3		8		5		2	1
Trafikimi i paligjshëm me droga narkotike	17	7	8	4	6	2	3	7	14	4
Trafiku i paligjshëm i armëve	2								2	2
Trafikimi i paligjshëm me mallra të vjedhura dhe të tjera Trafikim i mjeteve motorike	8								5	
Korrupsioni dhe ryshfeti	3		1		2		1		8	
Mashtrimi										
Falsifikimi i monedhës										
Falsifikimi dhe pirateria e produkteve	42		36	1	23	2	37	4	37	6
Krimi mjedisor										
Vrasje, lëndime të rënda trupore	21	5	13	2	10	2	9	4	16	5
Grabitja ose vjedhja	25	2	16	1	15	6	20	10	20	10
Kontrabanda										
Krime tatimore										
Zhvatja										
Falsifikimi										
Financimi i terrorizmit										
Terrorizmi	5		4	2	6		2	3	6	7
Gjithsej	133	16	96	11	85	13	91	28	121	41

Flukset dalëse

Siç përshkruhet në seksionin e kërcënimeve, shumica e llojeve të krimit që kanë të ardhura të konsiderueshme që dalin nga Kosova i dërgojnë paratë në vendet fqinje, dhe vetëm të ardhurat që rrjedhin nga mallrat e falsifikuara dhe mashtrimet duket se bëjnë përjashtim nga ky model. Përderisa posaçërisht pastrimi i shkallës më të vogël në vendet fqinje ka të ngjarë të bëhet përmes kontrabandimit të parave të gatshme, pastrimi në shkallë më të madhe dhe të ardhurat që shkojnë në vende më të largëta kanë më shumë gjasa të kalojnë nëpër sistemin financiar. Për më shumë informacione mbi fluksin dalës, shihni informacionet në seksionin e mësipërm të kërcënimeve për çdo lloj krimi.

Kërcënimi nga financimi i terrorizmit

Ekziston një mbivendosje e qartë ndërmjet pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit - si kriminelët ashtu edhe terroristët mund të përdorin metoda të ngjashme për të mbledhur, për të ruajtur dhe transferuar fonde. Megjithatë, financimi i terrorizmit mund të ndryshojë nga pastrimi i parave në dy aspekte. Së pari, fondet e përfshira në financimin e terrorizmit nuk duhet domosdoshmërisht të jenë të paligjshme; çka do të thotë se mund të mos jenë të ardhura të aktiviteteve të paligjshme. Së dyti, në pastrimin e parave ndodh shpesh që gjenerimi i fondeve të mund të jetë një qëllim në vetvete, për shembull, qëllimi i pastrimit është që në dukje të "legjitimohen" asetet. Në rastin e financimit të terrorizmit, qëllimi është të mbështeten aktet e terrorizmit, dhe për këtë arsye duhet që fondet, në pjesën më të madhe, të transferohen në një farë mënyre tek personat e lidhur me veprat e paligjshme.

Kosova nuk ka qenë kurrë shënjestër e sulmeve të mëdha terroriste, megjithatë duke e marrë parasysh, ndër të tjera, faktin se Kosova ka pasur luftëtarë që kanë shkuar në Siri dhe Irak, dhe një numër i konsiderueshëm i tyre janë kthyer në Kosovë, Kosova nuk mund ta injorojë kërcënimin nga financimi i terrorizmit (FT). Duke e marrë parasysh kërcënimin vendor të terrorizmit, kërcënimi më i rëndësishëm nga FT-ja vjen ose nga vetëfinancimi ose donacionet më të vogla nga donatorët e vullnetshëm/jo të vullnetshëm, ndërkohë që FT përmes OJQ-ve, të cilat përfshijnë burime financimi jashtë Kosovës, poashtu përbëjnë një kërcënim thelbësor.

Cenueshmëritë në subjektet raportuese

Ekspertët i vlerësojnë cenueshmëritë e përgjithshme të subjekteve të ndryshme raportuese në Kosovë duke e përdorur një shkallë prej 5 pikësh, që bazohet në shqyrtimin si të cenueshmërive të pandara/të brendshme ashtu edhe të kontrolleve të PP/FT-së (niveli i FT-së do të raportohet vetëm për subjektet raportuese aty ku është relevant), veçanërisht për pikat e mëposhtme:

- 1) Cenueshmëritë e pandara/të brendshme;
 - Madhësia e sektorit
 - Baza e klientëve, veçanërisht në atë shkallë që përfshin klientë me rrezik të lartë
 - Produktet e ofruara, veçanërisht në atë shkallë që përfshin produkte me rrezik të lartë
- 2) Kontrollat e PP/FT-së, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - KDK⁵²
 - Mbajtja e shënimeve/regjistrave
 - Monitorimi i transaksioneve dhe llogarive
 - Raportimi i RTD-ve
 - Të kuptuarit e vet rrezikut të tyre të PPP/LFT-së

Bankat

Paraqesin cenueshmëri **jashtëzakonisht të lartë** nga pastrimi i parave dhe cenueshmëri **të lartë** nga financimi i terrorizmit

Pothuajse të gjithë të rriturit në Kosovë përdorin një bankë për shërbime financiare, dhe ato janë thelbësore për funksionimin e të gjitha llojeve të biznesit në kuadër të ekonomisë formale. Në Kosovë funksionojnë dhjetë banka komerciale, që përfaqësojnë 67.5 për qind të totalit të aseteve në sektorin financiar, tetë nga të cilat janë në pronësi të huaj dhe përbëjnë rreth 88.9 për qind të totalit të aseteve të sistemit bankar. Dy banka vendase përbëjnë 11.1 përqindëshin e mbetur.

Sistemi bankar i Kosovës është i rregulluar mirë, fitimprurës dhe likuid. Banka Qendrore e Kosovës (BQK) është një agjenci e pavarur publike me autorizimin për t'i licencuar, mbikëqyrur

⁵² KDK-ja është procesi përmes të cilit një biznes verifikon identitetin e klientëve të vet dhe i vlerëson rreziqet e mundshme të PP/FT-së për marrëdhënien e biznesit

dhe rregulluar institucionet financiare dhe kompanitë e sigurimeve në Kosovë. BQK-ja i ka miratuar rregullat dhe rregulloret bankare në përputhje me Marrëveshjet e Bazelit dhe direktivat e BE-së.

Cenueshmëritë e pandara/të brendshme

Natyra, shkalla dhe kompleksiteti i bankave të Kosovës të shërbimeve me pakicë, i bëjnë ato të cenueshme në të gjitha fazat e procesit të PP-së dhe të cenueshme nga FT-ja për shkak të funksionit të tyre qendror në kuadër të sistemit financiar. Teksa gjasat që një klient ose transaksion specifik të përdoret për PP ose FT janë shumë të ulëta, vëllimi i të dyjave përbën një sfidë kryesore për bankat në drejtim të monitorimit dhe identifikimit të aktivitetit të dyshimtë.

Bankat e shërbimeve me pakicë ofrojnë një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh me karakteristika që e rrisin rrezikun nga PP/FT-ja. Karakteristikat e tilla përfshijnë:

- natyra me intensitet të lartë në para të gatshme të disa produkteve;
- aftësitë e transaksioneve online;
- pagesat elektronike në juridiksione të huaja;
- qasjen në shërbimet bankare nga palët e treta

Përhapja e gjerë e bazës së klientëve të bankave me pakicë e lë sektorin të cenueshëm nga PP-ja ose FT-ja. Baza e klientëve përfshin klientët që mund të kërkohen nga kriminelët për ta lehtësuar pastrimin e fondeve të paligjshme. Këto përfshijnë:

- Personat e Ekspozuar Politikisht;
- Individët me vlerë të lartë neto;
- Bizneset me përdorim intensiv të parave të gatshme, p.sh. kompanitë e ndërtimit, restorantet, baret, dyqanet e shitjes me pakicë, lojërat e fatit;
- Personat juridik dhe aranzhimet ;
- Organizatat bamirëse dhe jo-fitimprurëse;
- Avokatët, kontabilistët dhe profesionistët tjerë;
- Strukturat komplekse të korporatave.

Dihet se një bankë serbe vepron në veri të Kosovës pa leje nga BQK-ja, megjithatë është e paqartë se deri në çfarë shkalle vepron ajo nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e autoriteteve serbe, dhe as nuk ka ndonjë informacion në lidhje me madhësinë e saj, bazën e klientëve, produktet dhe shërbimet e ofruara.

Duke marrë parasysh se sektori bankar merret me shumicën dërrmuese të të gjitha transfertave ndërkombëtare që kalojnë nëpër sektorin financiar, ai është natyrshëm i ekspozuar tek PP/FT-ja ndërkombëtare, si gjatë hyrjes ashtu edhe gjatë daljes nga Kosova.

Kontrollet për PP/FT

Në përgjithësi, sektori bankar ka kontrolle shumë të forta për PP/FT, dhe krahasuar me shumë vende të tjera evropiane përdor një qasje shumë kundërshtuese ndaj rrezikut, për shembull, në përgjithësi nuk u shërbejnë personave jo-rezidentë. Tiparet e tjera që vlen të përmenden përfshijnë:

- Sektori bankar e ka kuptuar mirë rrezikun e vet për PP/FT, duke përfshirë edhe bërjen e vet të vlerësimit të bankave për rrezikun nga PP/FT.
- KDK-ja dhe mbajtja e shënimeve/regjistrave zbatohet në mënyrë efektive për të gjithë klientët, me zbatim të shkëlqyeshëm të KDK-së së zgjeruar
- Bankat kanë paraqitur 559 RTD në vitin 2018, çka konsiderohet të jetë një nivel i pranueshëm duke marrë parasysh madhësinë e sektorit bankar dhe cilësia e përgjithshme të RTD-ve është e mirë.
- Konsiderohet se bankat kanë zbatuar procedura shumë të forta dhe efektive për monitorimin e aktivitetit të transaksioneve të klientëve për ta zbuluar aktivitetin e PP/FT-së
- Zyrtarët e pajtueshmërisë në përgjithësi janë të trajnuar mirë, duke përfshirë pjesëmarrjen e shpeshtë në kurset e trajnimit ndërkombëtar

Tabela 20: Numri i RTD-ve nga bankat

2014	2015	2016	2017	2018	2019
234	350	438	683	559	785

Cenueshmëria e përgjithshme

Pavarësisht se sektori bankar konsiderohet të jetë sektori me kontrollet më të forta të PP/FT-së, ende konsiderohet tepër i cenueshëm ndaj PP-së për shkak të natyrës, shkallës dhe kompleksitetit të sektorit dhe rolit të tij qendror në shërbimet financiare të Kosovës.

Dërguesit e parave dhe agjentët e transfertave

Paraqesin cenueshmëri **nga të mesme** deri **në të lartë** nga pastrimi i parave dhe cenueshmëri **të lartë** nga financimi i terrorizmit

Remitancat janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për të paktën 43 për qind të popullsisë së Kosovës, duke përfaqësuar rreth 15 për qind të PBB-së (ose gati 1 miliard euro) në vitin 2017. Shumica e remitancave vijnë nga diaspora e Kosovës në vendet evropiane, veçanërisht në Gjermani dhe Zvicër⁵³. Banka Qendrore raporton se remitancat kryesisht përdoren për konsum personal, jo për qëllime investimi.⁵⁴

⁵³ Për më shumë informacione shihni:

<http://www.worldbank.org/en/topic/migrationremittancesdiasporaissues/brief/migration-remittances-data>

⁵⁴ <https://www.state.gov/e/eb/rls/othr/ics/2017/eur/269916.htm>

Shërbimet e ofruara nga firmat e remitancave shërbejnë si një sistem alternativ i transfertave të vlerave në vend të shërbimeve të ofruara nga bankat tradicionale dhe, përveç kësaj, ato shërbime shpesh kanë një shtrirje dhe depërtim më të gjerë gjeografik sesa shërbimet e ngjashme të ofruara nga bankat. Pjesa e tyre në transfertat totale ndërkombëtare është ende e vogël, pasi shumica dërrmuese e transaksioneve ndërkombëtare kryhet nëpërmjet bankave komerciale për shkak të kostove.

Aktualisht, ka 5 Biznese të Shërbimeve Monetare në Kosovë. Firmat e remitancave të parave janë veçanërisht atraktive, pasi që e bëjnë shumë të lehtë për klientët; p.sh. përdoruesit nuk kanë nevojë të hapin një llogari dhe transferimi bëhet brenda disa minutave. Përveç kësaj, ata shpesh kanë një shtrirje më të mirë globale krahasuar me bankat.

Cenueshmëritë e pandara/të brendshme

Shërbimet e remitancave veprojnë duke pranuar para në një lokacion të agjentit, të cilat më pas transferohen në mënyrë elektronike në vendndodhjen e marrësit, ku tërhiqen si para të gatshme nga marrësi.

Natyra e transaksioneve me vëllim të lartë dhe të bazuara në para të gatshme, është një cenueshmëri e rëndësishme për remituesit e parave, që zakonisht për nga natyra është me vlerë të vogël. Shërbimet u ofrohen klientëve mbi baza thjesht transaksionale, andaj në përgjithësi nuk formohet një marrëdhënie biznesi me klientin, gjë që i rrit shanset që të mos vërehen transaksionet e dyshimta .

Kontrollet për PP/FT

Të gjithë remituesit e parave që veprojnë në Kosovë janë kompani më të mëdha ndërkombëtare (Western Union është deri tani më i madhi në Kosovë) që globalisht e zbatojnë politikën e tyre PPP/LFT.

Detyrimet e mbajtjes së shënimeve/regjistrave kërkojnë që emetuesit dhe shitësit e urdhrave të parave ta verifikojnë dhe ta regjistrojnë identifikimin e klientëve për të gjitha urdhër pagesat në para të gatshme; megjithatë kjo nuk përfshin KDK-në e zgjeruar për klientët me rrezik të lartë si PEP-të.

Transmetuesit e parave kanë programe efektive PPP/LFT dhe ndihmojnë në parandalimin e pastrimit të parave duke paraqitur në kohë RTD-të që sinjalizojnë për strukturimin dhe aktivitetet tjera të dyshimta. Teksa sektori ka depozituar përafërsisht 15% të të gjithë RTD-ve në periudhën 2014-2017, shumica dërrmuese e tyre janë dorëzuar nga 2 kompanitë më të mëdha të remitancave. Kjo industri është e madhe dhe me shumë degë më të vogla në mbarë vendin, çka bën që mbajtja e mbikëqyrjes adekuate për ta siguruar pajtueshmërinë të jetë një sfidë e vazhdueshme.

Tabela 21: Numri i RTD-ve nga Agjencionet e Transferit të Parave

2014	2015	2016	2017	2018	2019
58	39	34	34	33	137

Cenueshmëria e përgjithshme

Përkundër përcjelljes së standardeve ndërkombëtare të industrisë për PPP/LFT, sektori gjithashtu kombinon bizneset me përdorim intensiv të parave të gatshme që i mundësojnë pagesat ndërkombëtare dhe një frekuencë të lartë të transaksioneve të tilla jashtë marrëdhënieve të biznesit, duke i bërë ato tërheqëse për pastruesit e parave dhe financuesit e terrorizmit.

Agjentët e këmbimit valutor

Paraqesin cenueshmëri **mesatare** nga pastrimi i parave

Aktualisht ekzistojnë 41 zyra të këmbimit valutor në Kosovë, kryesisht që kanë të bëjnë me transaksione të vogla që lidhen me shpenzimet personale, p.sh. turistë ose persona që udhëtojnë jashtë vendit.

Cenueshmëritë e pandara/të brendshme

Këmbimi valutor mund të jetë një instrument për të transferuar lehtësisht dhe fizikisht shuma të mëdha të të ardhurave kriminale. Në transaksionin e këmbimit valutor, paratë që rrjedhin nga krimet mund të konvertohen në valuta të ndryshme të huaja, megjithatë nuk konsiderohet se paratë e pista vihen në qarkullim ligjor nëpërmjet operacioneve të këmbimit. Përveç kësaj, të ardhurat kriminale mund të zhvendosen më lehtë përtej kufijve duke i ndërruar prerjet me vlerë të vogël me prerje të mëdha në monedha të ndryshme.

Kontrollet për PP/FT

Agjentët e këmbimit valutor nuk kanë kontrolle shumë të mira tradicionale të PPP/LFT-së, megjithatë një kufizim i rëndësishëm për PP/FT është se asnjë nga agjentët e këmbimit valutor në Kosovë nuk mund të transferojë fonde tek subjektet e tjera raportuese, siç janë bankat.

Tabela 22: Numri i RTD-ve nga Agjentët e këmbimit valutor

2014	2015	2016	2017	2018	2019
1	-	-	-	-	-

Cenueshmëria e përgjithshme

Cenueshmëria e përgjithshme e agjentëve të këmbimit valutor në Kosovë është e mesme, duke pasur parasysh intensitetin e parave të gatshme të bizneseve dhe mungesën e të kuptuarit bazë të PPP-së.

Institucionet mikro-financiare

Paraqesin cenueshmëri **të ulët** nga pastrimi i parave dhe cenueshmëri **mesatare** nga financimi i terrorizmit

Përveç bankave tregtare, Institucionet Mikrofinanciare (IMF) përfaqësojnë një faktor tjetër të rëndësishëm në tregun e huadhënies në Kosovë. Vlera totale e aseteve të IMF-ve arriti në 192.4 milion euro në vitin 2017.⁵⁵ Përfituesit kryesorë të huave/kredive të IMF-ve janë ekonomitë familjare (64 për qind e vlerës së huasë/kredisë) dhe ndërmarrjet e vogla (36 për qind e vlerës së huasë/kredisë). Madhësia mesatare e huave/kredive është përafërsisht 2,000 euro.⁵⁶

Cenueshmëritë e pandara/ të brendshme

Institucionet mikrofinanciare janë kryesisht të përfshira në operacionet e mikrokredisë në zonat rurale, ku ekziston një nivel i konsiderueshëm i ekonomisë joformale, por nuk duket se kanë si klientë lloje specifike klientësh me rrezik të lartë të PP-së, siç janë PEP-të ose individët me vlerë të lartë.

Kompanitë Mikrofinanciare ofrojnë vetëm një produkt shumë specifik, dhe duke pasur parasysh madhësinë e kredive nuk duket se janë në gjendje të pastrojnë sasi më të mëdha për individë.

Kontrollet për PP/FT

Në përgjithësi, kompanitë mikrofinanciare duket se i kanë njohuritë më bazike në lidhje me PPP/LFT, çka pjesërisht ilustruhet nga paraqitja e RTD-ve prej tyre.

Duke pasur parasysh natyrën e të qenit kompani huadhënëse, ato kanë arsye të forta për ta identifikuar klientin dhe për të mbajtur shënime të mira. Kompanitë mikrofinanciare zakonisht kanë një njohuri të mirë të bazës së tyre të klientëve të ndërtuar gjatë periudhave më të gjata kohore, çka e bën më të lehtë të zbulohen sjelljet e dyshimta.

Tabela 23: Numri i RTD-ve nga Institucionet Mikrofinanciare

2014	2015	2016	2017	2018	2019
-	2	6	5	10	15

⁵⁵ BQK, Raporti Vjetor 2017

https://bqk-kos.org/repository/docs/2017/CBK-17-08-2017_eng_AR_2016.pdf

⁵⁶ <http://amik.org/en/Microfinance-Sector-in-Kosovo/Current-Sector-Information>

Cenueshmëria e përgjithshme

Përkundër faktit se sektori i Mikrofinancës është i lidhur me vëllime të larta të transaksioneve në para të gatshme (të cilat zakonisht e rrisin rrezikun e PP/FT-së), konsiderohet se ka cenueshmëri të ulët nga PP-ja, pasi që shumat e parave të gatshme janë relativisht të ulëta, produktet e ofruara nuk janë veçanërisht interesante për qëllime të PP-së, dhe baza e klientëve konsiderohet si rrezik i ulët.

Kompanitë e Sigurimeve

Paraqesin cenueshmëri **të ulët** nga pastrimi i parave,

Aktualisht janë 15 kompani të licencuara të sigurimeve (përfshirë 3 kompani që ofrojnë sigurime jetësore) në kuadër të sektorit të sigurimeve, duke përfaqësuar rreth 3.0 për qind të totalit të aseteve të sistemit financiar; në vitin 2017 madhësia e aseteve të sektorit arriti në 176.8 milionë euro. Sigurimi jo-jetësor ka pjesën më të madhe në asetet totale të sektorit (rreth 87.8 për qind), ndërsa sigurimi jetësor përbën pjesën e mbetur të aseteve të shënuara.

Produktet e sigurimit jetësor mund të kategorizohen si: Mbrojtja, Pensionet, Kursimet dhe Investimet. Mbrojtja paguhet vetëm pas vdekjes, paaftësisë ose sëmundjes së rëndë dhe nuk fiton një vlerë dorëzimi. Fondet e pensioneve janë të paqasshme për një kohëzgjatje të konsiderueshme dhe paguhen vetëm në pension. Produktet e llojit të kursimit dhe investimeve ofrojnë polisa që mund të përdoren si kolateral për kredi apo investimet thjesht mund të ritërhiqen. Vetëm kjo e fundit konsiderohet një cenueshmëri relevante nga PP-ja.

Cenueshmëritë e pandara/ të brendshme

Kompanitë e sigurimit jetësor përfshihen në ofrimin e menaxhimit të pasurisë, i cili tradicionalisht konsiderohet me rrezik të lartë për PP. Dyshohet se ka një ndërveprim me PEP-të dhe klientët e tjerë me rrezik të lartë.

Tregu i sigurimit jetësor, kursimeve dhe investimeve është shumë i vogël në krahasim me të tjerë në sektorin financiar, por është gjithashtu një sektor i krijuar kohëve të fundit që ka gjasa të rritet në vitet në vijim.

Kontrollet për PP/FT

Sigurimi jetësor në disa vende shihet si një cenueshmëri nga PP-ja, sidomos për shkak se lejohen pagesa të larta në para të gatshme për heqjen dorë⁵⁷, por një tipar qendror në kompanitë e sigurimit jetësor në Kosovë është që të gjitha transaksionet nga klientët e tyre duhet të kalojnë nga llogaritë bankare të klientëve, gjë që dukshëm e zvogëlon atraktivitetin e sigurimit jetësor si një mjet aktiv për PP-në. Përveç kësaj, kompanitë e sigurimit jetësor kanë

⁵⁷ <http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/RBA-Life-Insurance.pdf>

marrëdhënie të vazhdueshme dhe të drejtpërdrejta me klientët e tyre, çka i bën më të prirura që t'i zbulojnë transaksionet e dyshimta.

Shihet se ofruesit e sigurimeve jetësore mirë i realizojnë KDK-të, mbajtjen të shënimeve/regjistrave dhe bëjnë monitorim të mirë të klientëve. Ofruesit e sigurimeve jetësore janë duke u mbikëqyrur në mënyrë aktive për qëllime të PPP/LFT-së, duke i përfshirë edhe inspektimet në vend.

Cenueshmëria e përgjithshme

Përveçse është një sektor i vogël me kontrole të mira tradicionale të PPP/LFT-së, ai nuk lejon pagesa në para të gatshme, por vetëm transaksionet nëpërmjet bankave, gjë që në masë të madhe e zvogëlon mundësinë e cenueshmërisë së sigurimit jetësor.

Lizingu financiar

Paraqet cenueshmëri **të ulët** nga pastrimi i parave

Lizingu financiar është në fazat e hershme të zhvillimit në Kosovë dhe kryesisht shërben për t'u siguruar mikro ndërmarrjeve lokale, atyre të vogla si dhe atyre të mesme qasje në një formë alternative të financimit. Aktiviteti kryesor është të sigurojë lizing financiar për automjete, pajisje ose makineri, si dhe pasuri të patundshme.

Cenueshmëritë e pandara/ të brendshme

Lizingu financiar ofron një listë shumë të ngushtë të produkteve që nuk duken veçanërisht tërheqëse për PP/FT. Një kontratë e lizingut financiar tregon një marrëveshje komerciale ku marrësi (klienti) zgjedh një aset, dhe dhënësi do ta blejë asetin, dhe marrësi e shfrytëzon këtë aset në këmbim të një serie kështesh që ia paguan dhënësit.

Kontrollet për PP/FT

Kompanitë e lizingut financiar kanë kontrole të mira tradicionale të PPP/LFT-së, si KDK-ja dhe mbajtja e shënimeve/regjistrave, si dhe kanë zyrtarët e tyre të pajtueshmërisë me njohuri të mira të PPP/LFT-së. Përveç kësaj, kompanitë e lizingut kanë një marrëdhënie të vazhdueshme me klientët e tyre, çka i bën më të prirura t'i zbulojnë transaksionet e dyshimta, megjithatë, duke qenë se sektori është në fazat e zhvillimit, mund të mos kenë një tablo të plotë të rreziqeve nga PP me të cilat përballen.

Cenueshmëria e përgjithshme

Madhësia shumë e kufizuar e sektorit që nuk ofron produkte të cilat janë veçanërisht tërheqëse për PP/FT, dhe që kombinohet me kontrole të mira të PPP/LFT-së, e bëjnë lizingun financiar të ketë cenueshmëri të ulët.

Fondet pensionale

Paraqesin cenueshmëri **jashtëzakonisht të ulët** nga pastrimi i parave

Ekzistojnë dy fonde pensionale, përkatësisht Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) me një mandat ekskluziv për t'i administruar kontributet e detyrueshme pensionale dhe Fondi Sllloven-Kosovar i Pensioneve (FSKP) që i administron vetëm fondet e pensionit vullnetar. Sektori është sektori i dytë më i madh në sektorin financiar, me 27.9 për qind të totalit të aseteve financiare, prej të cilëve mbi 99.5 për qind administrohen nga FKPK-ja.

Cenueshmëritë e pandara/ të brendshme

Cenueshmëritë kryesore të fondeve pensionale kanë të bëjnë me madhësinë dhe mbulimin e popullsisë së Kosovës, që ka të ngjarë t'i përfshijë PEP-të dhe klientët tjerë me rrezik të lartë. Megjithatë, 99.5 për qind e kontributeve kanë të bëjnë me kontributin e detyrueshëm.

Kontrollet për PP/FT

Sektori është shumë jo tërheqës për PP/FT për shkak të llojit të produktit që e ofron, madje edhe asetet që lidhen me kontributet vullnetare, të gjitha duhet të bëhen nëpërmjet sektorit bankar, dhe është e mundur të rifitohen asetet vetëm kur klientët ta arrijnë pensionin e moshës.

Cenueshmëria e përgjithshme

Përkundër madhësisë së sektorit, cenueshmëria e përgjithshme nga PP-ja është jashtëzakonisht e ulët, për shkak se produkti i ofruar nga sektori nuk është i favorshëm për pastrimin e parave.

Patundshmëritë dhe Ndërtimtaria

Paraqesin cenueshmëri **jashtëzakonisht të lartë** nga pastrimi i parave

Sektori i ndërtimit shërben si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë së Kosovës, dhe përkundër sfidave ka vazhduar të zgjerohet edhe gjatë krizës ekonomike në Evropë. Me një pjesëmarrje prej 9.5%, sektori i ndërtimit ishte punëdhënësi i katërt më i madh në Kosovë në vitin 2014, duke punësuar rreth 39.000 persona.⁵⁸ IHD-të në Kosovë gjatë viteve 2011-2016 ishin kryesisht të përqendruara në patundshmëri me 56.3%, dhe ndërtim me 12.7%.⁵⁹

Në trajtimin e këtij sektori është e rëndësishme të pranojmë se ky sektor përmban kërcënim dhe cenueshmëri nga PP-ja. Kërcënimi lidhet me informalitetin e përhapur aktualisht në sektorin e ndërtimit, ku evazioni fiskal nga pagesat e padeklaruaratë nënvlerësuaratë është i shfrenuar (për

⁵⁸ http://helvetas-ks.org/eye/file/repository/Market_Assessment_for_the_Construction_Sector_ENG.pdf

⁵⁹ <https://assets.kpmg.com/content/dam/kpmg/bg/pdf/Investment-in-Kosovo-2017.pdf>

më shumë informacione shihni seksionin për evazionin fiskal). Përveç kësaj, nuk është e pazakontë të gjesh raste mashtrimi në këtë sektor në të cilin faturat e falsifikuara përdoren në biznesin e ndërtimit për t'i ngritur shpenzimet. Pjesa e mbetur e këtij seksioni do të merret vetëm me shkallën në të cilën sektori përdoret për pastrimin e parave dhe jo me masën që gjeneron të ardhura nga krimi.

Cenueshmëritë e pandara/ të brendshme

Sektori ofron produkte dhe shërbime që janë të cenueshme ndaj pastrimit të parave, duke përfshirë zhvillimin e tokës, ndërtimin e ndërtesave të reja dhe shitjen e tyre të mëvonshme. Sektori është i ekspozuar ndaj klientëve me rrezik të lartë, duke i përfshirë PEP-të, investitorë të huaj dhe individë në profesione dhe biznese të cenueshme.

Një rast tipik i pastrimit të parave në ndërtim shpesh përfshin investimin e një sasive të madhe parash nga një individ që shfaqet si klient dhe një shitje tjetër më pas, e cila fsheh origjinën e paligjshme të parave të investuara në punët ndërtimore fillestare.

Cenueshmëria e sektorit shkaktohet kryesisht nga fakti që pagesat për material ndërtimor dhe të punës shpesh bëhen në para të gatshme. Paratë e gatshme përdoren gjerësisht për financimin e biznesit të ndërtimit, pa ndonjë shpjegim të duhur për origjinën e tyre.

Patundshmëria konsiderohet gjithashtu një sektor i cenueshëm ndaj pastrimit të parave, por kur konsiderohen kufizimet në blerjen përmes parave të gatshme (shih kontrollet e PP-së), kjo do të thotë që në përgjithësi kjo do t'i përfshijë noterët, të cilët me dashje ose pa dashje do ta nënvlerësojnë pronën.⁶⁰ Policia i ka regjistruar rastet e kohëve të fundit në të cilat personat e blejnë shtëpinë pjesërisht me para të gatshme nga aktivitetet kriminale.

Kontrollet për PP/FT

Çdo transaksion për shitjen/blerjen e pasurisë mbi 10,000 euro në vlerë duhet të shlyhet nëpërmjet një transferi bankar, përndryshe nuk do të regjistrohet në kadastër, prandaj bankat kanë një rol të mundshëm parandalues në monitorimin e transaksioneve të patundshmërive. Kjo e zvogëlon në masë të madhe edhe mundësinë për të përdorur të ardhura të paligjshme në para të gatshme për të blerë patundshmëri.

Cenueshmëria e përgjithshme

Përgjithësisht pranohet se ky sektor është tepër atraktiv për shumë klientë me rrezik të lartë, duke përfshirë PEP-të, dhe kjo është përforcuar me përhapjen e gjerë të informalitetit.

⁶⁰ Rasti i përgjithshëm është që një pronë është nënvlerësuar, e blerë pjesërisht me transferte bankare (çmimi i njohur me anë të noterit) dhe të ardhurat e paligjshme do të përdoren për të paguar "nën tryezë" për pjesën e mbetur, e pastaj prona mund të shitet me çmim të plotë.

Noterët

Paraqesin cenueshmëri **të lartë** nga pastrimi i parave

Noterët në Kosovë organizohen përmes Odës së Noterëve të Kosovës (ONK). Ministri i Drejtësisë e përcakton numrin e përgjithshëm të noterëve dhe mbulimin relativ për secilën komunë. Në Kosovë janë rreth 80 noterë. Noterët mund të përfshihen në të gjitha transaksionet që lidhen me shitjen e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, duke përfshirë pasurinë e patundshme, dhe si të tillë kanë një rol shtesë në regjimin parandalues për transaksionet e patundshmërive.

Cenueshmëritë e pandara/ të brendshme

Noterët nuk janë të përfshirë drejtpërsëdrejti në pastrimin e të ardhurave, por veprojnë si mundësues për pastruesin. Rasti i përgjithshëm është një pronë e blerë me çmim të nënvlerësuar, me çmimin që pranohet nëpërmjet noterit. Të ardhurat e paligjshme më pas do të përdoren për të paguar "nën tryezë" për pjesën e mbetur. Prona më vonë mund të shitet me çmim të plotë. Kjo mund të ndodhë me pëlqimin e noterit ose pa dijeni nga ana e tij/saj (shumica dërmuese e rasteve dyshohet të jenë pa dijeninë e noterit).

Kontrollet për PP/FT

Teksa disa noterë kanë treguar se janë të vetëdijshëm për rolin dhe rrezikun e tyre në kuadër të PPP-së të Kosovës (duke përfshirë edhe dorëzimin e RTD-ve), kjo nuk duket se shtrihet në të gjithë sektorin. Përveç kësaj, ndryshimet e mëdha në çmimet e patundshmërive dhe vlerat në rritje (sidomos në qytetet më të mëdha) e bëjnë më të vështirë që noterët të zbulojnë aktivitete të dyshimta.

Tabela 24: Numri i RTD-ve nga noterët

2014	2015	2016	2017	2018	2019
-	-	2	-	37	68

Cenueshmëritë e përgjithshme

Duke marrë parasysh cenueshmërinë e lartë në lidhje me pasurinë e patundshme (shih pjesën e mësipërme), në shumicën e rasteve kjo do të përfshinte miratimin me dashje ose pa dashje të noterit dhe do të jetë e natyrshme që noterët të klasifikohen si me cenueshmëri të lartë.

Personat juridik dhe aranzhimet

Paraqesin cenueshmëri **të lartë** nga pastrimi i parave

Llojet e mëposhtme të personave juridik mund të themelohen në Kosovë sipas legjislacionit në fuqi; Biznesi Individual⁶¹, Ortakëri e përgjithshme,⁶² Ortakëri e kufizuar⁶³, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara,⁶⁴ Shoqëri aksionare,⁶⁵ ose Biznes personal.⁶⁶

Korniza e mbikëqyrjes për LPP/LFT është e konsoliduar, kryesisht nën BQK-në dhe NJIF-in. Për institucionet financiare, BQK-ja është autoriteti kryesor i licencimit dhe mbikëqyrjes, si për qëllimet LPP/LFT ashtu edhe për qëllimet jo të PPP/LFT-së. Në të njëjtën kohë përcaktohet edhe NJIF-i si mbikëqyrësi i FPP/LFT për IF-të:

Cenueshmëritë e pandara/ të brendshme

Duke pasur parasysh madhësinë e ekonomisë informale dhe që shumë prej llojeve të krimit në Kosovë kryesisht gjenerojnë të ardhura në formë të parasë së gatshme, bizneset me përdorim intensiv të parave të gatshme janë të prirura për t'u keqpërdorur për PP. Përveç sektorëve tashmë të mbuluar veçmas të ndërtimit dhe të lojërave të fatit, biznese të tjera në kuadër të sektorit të shitjeve me pakicë dhe shërbimeve, p.sh. bare dhe restorante, janë të cenueshme për të funksionuar si biznese që i kombinojnë të ardhurat e paligjshme me të ardhurat nga veprimet e ligjshme, duke errësuar burimin, pronësinë dhe kontrollin e fondeve të paligjshme. Kur një kompani përdoret si mbulesë për të depozituar, lëvizur ose përdorur të ardhura të paligjshme, mund të jetë e vështirë për bankën që e mban llogarinë ta dijë se aktiviteti bankar i kompanisë përfshin pastrimin e parave.

Informatat e pasakta në lidhje me pronësinë përfituese të kompanive njihen gjerësisht si cenueshmëri të rëndësishme nga PP-ja.⁶⁷ Edhe përdorimi i kompanive guacë ose vendeve tej-oqeanike konsiderohet se përdoret për pastrimin e të ardhurave të konsiderueshme që rrjedhin nga Kosova, duke qenë se Policia e Kosovës ka hetuar disa raste të lidhura me transaksionet tej-oqeanike. Megjithatë, konsiderohet si një cenueshmëri e dukshme që informacioni i pasaktë i pronësisë përfituese lejon që kompanitë në Kosovë t'i devijojnë fondet publike të lidhura me korrupsionin nga prokurimi dhe ta anashkalojnë shqyrtimin e PEP-ve nga bankat.

61 Një subjekt që mund të formohet dhe të zotërohet vetëm nga një person fizik.

62 Një subjekt që mund të formohet dhe të zotërohet vetëm nga një person fizik.

63 Një ortakëri e formuar nga të paktën një ortak i përgjithshëm dhe të paktën një ortak i kufizuar.

64 Personi juridik i formuar dhe i zotëruar nga një ose më shumë persona fizikë ose juridikë, duke përfshirë OJQ-të.

65 Personi juridik në pronësi të aksionarëve të vet, por është ligjërish i ndarë dhe i dallueshëm nga aksionarët e vet.

66 Nuk ka personalitet juridik

67 Për më shumë informacion shih <http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/FATF-Egmont-Concealment-beneficial-ownership.pdf>

Përdorimi i kompanive mbulesë me pronësi të pasaktë përfituese besohet të jetë një metodë e zakonshme e PP-së që u lejon kompanive të regjistruara nga miqtë t'i kalojnë të ardhurat në kompani të tjera në pronësi të bashkëpunëtorëve të tjerë ose të afërmeve të PEP-ve.

Kontrollet

Ligji për Shoqëritë Tregtare parashikon procesin e krijimit të një personi juridik dhe dorëzimin e informatave themelore të pronësisë në Regjistrin e Organizatave të Biznesit dhe Emrave Tregtarë të Kosovës. Regjistri i Biznesit është një regjistër qendror që mban të dhënat e të gjitha kompanive të regjistruara, megjithatë për shkak të kufizimeve të burimeve ka pak ekzaminim ose përditësim të informacionit të ofruar.

Cenueshmëritë e përgjithshme

Si në shumicën e vendeve, bizneset me përdorim intensiv të parave të gatshme janë të cenueshme për t'u përdorur si biznese mbulesë për PP, pasi që madhësia e ekonomisë informale e përshkallëzon problemin. Përveç kësaj, çështjet e informacionit të pasaktë të pronësisë përfituese shihen si një cenueshmëri e konsiderueshme nga PP-ja, sidomos nga korrupsioni në prokurim.

Lojërat e fatit

Paraqesin cenueshmëri **të lartë** nga pastrimi i parave

Deri në Maj të vitit 2019, lojërat e fatit kanë qenë të ligjshme në Kosovë dhe Administrata Tatimore ka qenë autoriteti rregullativ që e ka mbikëqyr tërë sektorin. Por me ligj⁶⁸ janë ndaluar dhe mbyllur të gjitha lojërat e fatit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Nuk ka pasur kazino të regjistruara në Kosovë, megjithatë deri në vitin 2019 kanë qenë 41 lojëra të fatit, duke përfshirë automatet (aktiviteti kryesor), bingot, tombola, bastore sportive dhe një lotari publike. Sektori ka qenë i mbikëqyrtur nga Administrata Tatimore (për tatime) dhe NJJF-i (për qëllime PPP/LFT).

Duhet gjithashtu të përmendet se kanë ekzistuar dëshmi se lojërat e fatit kanë qenë burim i të ardhurave nga krimi, veçanërisht nga evazioni fiskal, p.sh. nëpërmjet manipulimit të regjistrimit të numrave të automateve, megjithatë teksti i mëposhtëm trajton vetëm aspektin e cenueshmërisë.

Cenueshmëritë e pandara/ të brendshme

Ashtu si edhe me bizneset e tjera të stimulimit të parave të gatshme në Kosovë, ka ekzistuar një rrezik që pronarët e kompanive të lojërave të fatit t'i kenë përdorur bizneset e tyre si biznese mbulesë, ku një pjesë e rëndësishme e të ardhurave dyshohet se kanë qenë të ardhurat nga krimi, ndërsa janë paraqitur si të ardhura nga klientët. Regjistri i biznesit i ARBK-së nuk ka qenë

⁶⁸ Nr. 06/L -155 për ndalimin e lojërave të fatit: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2813>

i përditësuar dhe nuk ka mund të përdoret si burim i besueshëm që tregon pronësinë ose personin përgjegjës në kompanitë e lojërave të fatit.

Klientët kanë mundur të angazhohen në lojëra të fatit në mënyrë relativisht anonime, edhe pse kanë qenë të monitoruara dhe disa aktivitete kanë kërkuar ndërveprim sy më sy me stafin. Përkundër këtij monitorimi, nuk ka pasur identifikim të klientit apo verifikim të burimit të fondeve.

Kontrollet për PP/FT

Sektori i lojërave të fatit nuk duket se ka zbatuar ndonjë masë specifike të PPP, siç janë KDK-ja, mbajtja e shënimeve/regjistrave, etj.

Me sa duket asnjë prej lojërave të fatit nuk ju ka ofruar klientëve të tyre mundësinë për të transferuar fonde në mënyrë elektronike, çka do të lejonte që fondet të dërgoheshin në sektorin financiar, gjë që pagesat e klientëve janë bërë në formën e parave të gatshme. Përveç kësaj, vetëm bastet sportive dhe lotaria u ofrojnë klientëve faturat për t'i verifikuar fitimet. Kjo duket se e kufizon disi cënueshmërinë e sektorit.

Cënueshmëria e përgjithshme

Duke pasur parasysh intensitetin në para të gatshme të biznesit, dhe se sektori ka qenë shumë i parregulluar për qëllime të PP-së, këto kanë qenë arsyet themelore që e kanë bërë sektorin shumë të cënueshëm.

OJQ-të

Paraqesin cënueshmëri **mesatare nga** pastrimi i parave dhe cënueshmëri **të lartë** nga financimi i terrorizmit

Kosova ka një sektor të gjerë dhe të larmishëm të OJQ-ve ,me pothuajse 10,800 OJQ të regjistruara që përmbushin shumë role të rëndësishme për shoqërinë në Kosovë. OJQ-të zakonisht financohen nga donacionet, por disa krejtësisht i shmangin financimet formale dhe drejtohen kryesisht nga vullnetarët. Departamenti për OJQ-të (DOJQ) në kuadër të Ministrisë për Administratë Publike, është autoriteti kompetent për zbatimin e Ligjit për Lirinë e Asociimit në OJQ.

Cënueshmëritë e pandara/ të brendshme

Nuk ka pasur raste të OJQ-ve në Kosovë të lidhura drejtpërdrejt me terrorizëm apo financimin e terrorizmit. Megjithatë, gjatë viteve 2014 deri 2019 në raste të veqanta veprimtaria e rreth 23 OJQ-ve me karakter fetar u suspendua edhe në bazë të dyshimit se vepronin në kundërshtim me legjislacionin e Kosovës dhe se ishin gjithashtu të përfshira në nxitjen e urrejtjes fetare dhe

ndërsektare.⁶⁹ Sidoqoftë, korniza aktuale ligjore nuk e lejon pezullimin e përhershëm të aktiviteteve të një OJQ-je individuale bazuar vetëm në inteligjencë. Pezullimet duhet të rinovohen në baza të rregullta dhe shpesh nuk është e mundur (për arsye të sigurisë kombëtare) të jepen dëshmi në gjykatë për ta justifikuar pezullimin e vazhdueshëm. Kjo rezulton në rihapjen e OJQ-ve që më parë ju ishin pezulluar veprimtaria nën dyshimin e lidhjeve me Financimin e Terrorizmit dhe/ose radikalizimin.

Duhet të theksohen dy dobësi specifike në sektorin e OJQ-ve në Kosovë: 1) mos-verifikimi i fondeve, dhe 2) informatat e mundshme të pasakta të regjistrimit.

Pasi të themelohet dhe të regjistrohet krijohet një OJQ, ka pak kujdes të duhur të vazhdueshëm në lidhje me hyrjet dhe daljet financiare. Për shkak të mungesës së përgjithshme të burimeve dhe se Departamenti i OJQ-ve i Ministrisë për Administratë Publike është përgjegjës për regjistrimin e OJQ-ve por që nuk ka mandat mbikëqyrjen e mijëra OJQ-ve të regjistruara, nuk është e mundur që të gjitha organizatat të monitorohen në mënyrë adekuate. Nëse burimi i fondeve që vijnë nga donatorë vendas apo të huaj nuk mund të verifikohet, atëherë kjo është një cenueshmëri e dukshme; dhe cenueshmëria nga FT-ja rritet edhe më tej në raport me shkallën që fondet vijnë nga vende me lidhje të dokumentuara me radikalizimin dhe financimin e terrorizmit. Mungesa e mekanizmave efikase për verifikimin e burimit të fondeve që vijnë në OJF/OJQ nga vende të huaja është një problem i veçantë me burimin e fondeve për OJQ-të fetare.

Shumë nga OJQ-të në Kosovë marrin fonde publike. Mund të ketë pasur raste kur politikanët i kanë shfrytëzuar cenueshmëritë e mbikëqyrjes financiare të OJQ-ve që t'i përdorin për ta devijuar financimin publik për përfitime personale, dhe në mënyrë të ngjashme OJQ-të mund të funksionojnë edhe si një mjet për rryshfet.

Edhe pse procedurat e regjistrimit mund të duken të kënaqshme, nuk ka kontroll apo përditësim të informacionit në lidhje me OJQ-të, pas regjistrimit OJQ-të janë të obliguar që në afat prej 30 ditësh ta njoftojnë Departamenti për ndryshimet e të dhëna me rastin e regjistrimit, por ka të tilla të cilat nuk paraqesin kërkesë për ndryshimin e të dhënave. Për ta shmangur shqyrtimin, disa OJQ/OJF të sapoformuara janë qëllimisht duke mashtruar për qëllimin ose kategorinë e organizatës, për ndryshe Departamenti menjëherë e bënë përditësimin e të dhëna dhe kohë reale i vëhet në dispozicion publikut në Regjistrin Publik të OJQ-ve⁷⁰. Dëshmitë nga të dhënat e pasakta mbi statusin e OJF-ve të regjistruara tregojnë se departamenti i OJQ-ve nuk ka staf të mjaftueshëm për të qenë në gjendje ta përmbushë siç duhet mandatin e vet.

⁶⁹ Policia e Kosovës 2016, Vlerësimi i Kërcënimit të Krimeve të Rënda dhe Krimit të Organizuar

⁷⁰ shih web faqen e DOJQ/MAP

Kjo e bën të vështirë për aktorët përkatës⁷¹ që të ndërmarrin një qasje kuptimplotë të bazuar në rrezik në sektorin e OJQ-ve, ku shumë organizata mund të klasifikohen me rrezik të ulët nëse ka informacion të saktë në dispozicion, veçanërisht për FT-në.

Përveç rrezikut të brendshëm të PP/FT-së, mbledhja e fondeve bamirëse nga OJQ-të gjithashtu ngre shqetësime në lidhje me financimin e terrorizmit që dërgohet jashtë Kosovës. Mjete të tilla mund të grumbullohen për arsyet e deklaruara të mbështetjes së ndihmës humanitare në zonat e konfliktit. Përderisa nuk ka dëshmi për të sugjeruar që fondet e tilla po keqpërdoren, mund të jetë e vështirë të përcaktohet besueshmëria e këtyre grupeve.

Kontrollet për PP/FT

NJIF-K dhe organizata të tjera relevante bashkëpunojnë me Departamentin e Qeverisë për OJQ për t'i kryer hetimet e kujdesit të duhur në lidhje me personat e huaj që kërkojnë të themelojnë OJQ, ose që punojnë në kuadër të këtyre organizatave. Megjithatë, NJIF nuk ka qasje në bazën e të dhënave komerciale të NJKT/KDK për t'i kontrolluar personat e lidhur me OJQ-të e huaja. Mungesa e NJKT/KDD të detajuar kur regjistrohen OJQ-të e reja. Mungesa e kapaciteteve brenda departamentit të regjistrimit të OJQ-ve. Departamenti ka kapacitete për realizimin e detyrave vetëm në kuadër të kompetencave që ka momentalisht. Atyre u kërkohet t'i verifikojnë personat që aplikojnë për të themeluar OJF/OJQ dhe ta kryejnë kujdesin e duhur në lidhje me punën e secilës OJF/OJQ⁷².

Cenueshmëria e përgjithshme

Rreziku i përgjithshëm nga PP/FT në sektorin e organizatave jofitimprurëse vlerësohet të jetë mesatar për PP dhe i lartë për FT. Kjo është për shkak të faktit se nuk ka dëshmi të drejtpërdrejta deri më sot të abuzimit të këtij sektori për qëllimin e financimit të terrorizmit. Pranohet se pasqyra aktuale në lidhje me sektorin e bamirësisë nuk është e plotë dhe nuk ka mbikëqyrje efektive mbi financimet hyrëse/dalëse.

Tregtarët me vlera të larta

Paraqesin cenueshmëri **mesatare** nga pastrimi i parave dhe cenueshmëri **mesatare** nga financimi i terrorizmit

Kjo kategori kryesisht përbëhet nga dy lloje të subjekteve: 1) Tregtarët e metaleve dhe gurëve të çmuar (TMGÇ) dhe 2) tregtarët e makinave.

- 1) Ekzistojnë disa qindra TMGÇ të vendosur anembanë Kosovës që radhiten nga tregtarët e mëdhenj tek ata shumë të vegjël dhe që janë mjaft të qasshëm për klientët vendas.

⁷¹ Si bankat kur marrin një OJQ si klient të ri

⁷² Vlerësimi Specifik për Sektorin i Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të terrorizmit në sektorin e Organizatave jo qeveritare/Organizatave jo-fitimprurëse (OJQ/OJF) në Kosovë 2018

Tregtarët e metaleve dhe gurëve të çmuar janë individë ose persona juridikë. Ata duhet të certifikohen nga Instituti i Metrologjisë Ligjore të Kosovës - aktualisht Agjencia e Metrologjisë në kuadër të MTI-së.

2) Shitësit e makinave, posaçërisht të makinave të shtrenjta/luksoze.

Cenueshmëritë e pandara/ të brendshme

Tregtarët me vlerë të lartë janë të vendosur në të gjithë Kosovën, janë shumë të qasshëm për klientët dhe kryejnë një vëllim të madh të biznesit në këto mallra me vlerë të lartë që janë të cenueshme ndaj pastrimit të parave, veçanërisht pasi janë një plasim tërheqës i të ardhurave të kriminit; si TMGÇ-të ashtu dhe tregtarët e makinave ofrojnë një mënyrë të lehtë për konvertimin e një sasive relativisht të madhe parash të gatshme në mallra të qëndrueshme. Për më tepër, tregtarët me vlera të mëdha kanë marrëdhënie të vetme transaksionale me klientët e tyre, prandaj ka mundësi që klientët të kryejnë transaksione me para të gatshme me një shkallë të lartë anonimiteti, ku mund të jetë e vështirë të zbulohen transaksionet e dyshimta.

Përveç kësaj, TMGÇ-të mund të jenë të cenueshëm ndaj FT-së ose nga persona që blejnë nga TMGÇ-të për të dërguar/dhënë mjete për ta financuar terrorizmin duke e shmangur rrezikun e kontrabandës së parave të gatshme, ose me sende të vjedhura (si në Kosovë ashtu edhe jashtë) që mund të shiten në dyqanet TMGÇ për të marrë para dhe për ta financuar terrorizmin.

Kontrollet për PP/FT

Si çdo person që bën tregti në mallra që pranojnë pagesa në para të gatshme prej 10,000 euro ose më shumë në një transaksion të vetëm ose në një seri transaksionesh të lidhura ose transaksionesh dukshëm të lidhura, kur arrihet ky prag, tregtarët me vlera të larta duhet t'i zbatojnë masat e KDK-së për transaksione të tilla, të mbajnë shënime adekuate për transaksionet dhe TMGÇ-të përcaktohen në mënyrë specifike si subjekte raportuese që duhet të raportojnë transaksione të dyshimta, nëse zbulohen. Megjithatë, duket e qartë se jo të gjithë TMGÇ-të janë në dijeni për këtë ose e respektojnë detyrimin e tyre për PPP/LFT.

Rreziku i përgjithshëm

Rreziku i përgjithshëm nga PP/FT në kuadër të sektorit të TMGÇ-ve gjykohet të jetë i mesëm, kryesisht i nxitur nga natyra me përdorim intensiv të parave të gatshme nga bizneset e TMGÇ-ve, natyra e produkteve të ofruara dhe vlera e tyre e brendshme.

Avokatët

Paraqesin cenueshmëri **të ulët** nga pastrimi i parave

Avokatët në Kosovë organizohen përmes Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK). Veprimtaria e Odës dhe organizimi i saj rregullohen nga Ligji për Avokatinë Nr. 04/L-193, Statuti i OAK-së dhe Kodi i Etikës për Avokatët; aktualisht ka mbi 800 avokatë praktikues në Kosovë, megjithatë shumica e tyre janë avokatë civilë ose penal, dhe vetëm pak avokatë janë të përfshirë në transaksionet ekonomike.

Cenueshmëritë e pandara/ të brendshme

Avokatëve mund t'u kërkohet të ndihmojnë në strukturimin dhe dizajnin e transaksioneve që synojnë ta fshehin natyrën dhe origjinën e fondeve. Shërbimet relevante për të cilat avokatët janë të rëndësishëm në PP në Kosovë kryesisht kanë të bëjnë me:

Trajtimin e parave të klientit;

- Menaxhimin e pasurive dhe llogarive financiare të klientit;
- Ndihmën në blerjen ose shitjen e tokës ose subjekteve afariste

Klientët e avokatëve, si korporata ashtu edhe individë, vijnë nga të gjitha fushat e veprimtarisë tregtare dhe në mënyrë të pashmangshme përfshijnë klientë me rrezik të lartë, siç janë:

- Klientët me vlerë të lartë neto;
- Personat e ekspozuar politikisht; dhe
- Klientë të tjerë të njohur me rrezik të lartë për qëllime të pastrimit të parave, p.sh. bizneset me përdorim intensiv të parave të gatshme, transaksionet e ndërtimit apo të pasurive të patundshme etj.

Kontrollet për PP/FT

Ofrimi i këshillave juridike mbrohet nga privilegji mes avokatit dhe klientit, gjë që mund ta bëjë këtë marrëdhënie të biznesit më të padepërtueshme për autoritetet kompetente. Megjithatë, krahasuar me shumicën e vendeve të tjera evropiane, nuk ka treg të trusteve apo letrave me vlerë, të cilat mund të jenë një mjet potencial për avokatët, dhe nuk ka as shenja se ndonjë avokat në Kosovë është i specializuar në krijimin e llogarive tej-oqeanike.

Teksa avokatët shfaqin disa shenja të të kuptuarit të rrezikut të tyre nga PP-ja, p.sh. këtë vit ata paraqitën RTD për herë të parë, nuk është e qartë se kjo vlen për të gjithë sektorin.

Cenueshmëria e përgjithshme

Përderisa ndërgjegjësimi dhe pajtueshmëria me detyrimet e PPP/LFT-së është përmirësuar për sektorin e shërbimeve juridike, natyra e shërbimeve të ofruara nga disa profesionistë ligjorë, klientët dhe niveli i ulët i raportimit të RTD-ve, kanë tendencë që ta zvogëlojnë cenueshmërinë nga pastrimi i parave.

Kontabilistët dhe auditorët

Paraqesin cenueshmëri **të ulët** nga pastrimi i parave
dhe cenueshmëri **të ulët** nga financimi i terrorizmit

Sektori i kontabilitetit përfshin firma të mëdha ndërkombëtare, biznese të vogla lokale, si dhe profesionistë të pavarur. Aktivitetet e kryera nga ky sektor përfshijnë mbajtjen e llogarive dhe kontabilitetin, konsulencën tatimore dhe auditimin. Gjithashtu firmat më të mëdha i shoqërojnë transaksionet kapitale.

Cenueshmëritë e pandara/ të brendshme

Ngjashëm me sektorin e shërbimeve juridike, natyra e specializuar e njohurive dhe shërbimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të kontabilitetit, i bën ata të cenueshëm për t'u kërkuar dhe shfrytëzuar nga ata që kërkojnë t'i pastrojnë të ardhurat e krimit ose t'u shmangen taksave. Është e pranuar në udhëzimet ndërkombëtare të bazuara në rrezik që ofruesve të shërbimeve të kontabilitetit mund t'u kërkojë të ndihmojnë në strukturimin dhe dizajnin e transaksioneve që synojnë të fshehin natyrën dhe origjinën e fondeve.

Klientët e shërbimeve të kontabilitetit, si korporata ashtu edhe individë, vijnë nga të gjitha fushat e veprimtarisë tregtare dhe në mënyrë të pashmangshme përfshijnë klientë me rrezik të lartë, siç janë:

- Klientët me vlerë të lartë neto;
- Personat e ekspozuar politikisht; dhe
- Klientë të tjerë të njohur me rrezik të lartë për qëllime të pastrimit të parave, p.sh. bizneset me përdorim intensiv të parave të gatshme, transaksionet e ndërtimit apo të pasurive të patundshme etj.

Cenueshmëria nga FT-ja ka të bëjë me detyrimin për OJQ-të që të dorëzojnë në MAP/Departamentin për regjistrimin e OJQ-ve një raport të auditimit, prandaj roli i auditorit është i rëndësishëm në aktivitetet monitoruese të OJQ-së.

Kontrollet për PP/FT

Firmat më të mëdha ndërkombëtare të kontabilitetit që veprojnë në Kosovë, në përgjithësi zbatojnë politikat e tyre të PPP/LFT-së në nivel global, ndërkohë që kompanitë më të vogla shfaqin më shumë kufizime në njohuritë e tyre për rrezikun nga PP/FT të paraqitur nga klientët, dhe për detyrimet e tyre në sistemin e PPP/LFT-së.

Mungesa e raportimit të RTD-ve mund të jetë një shenjë se ka pak PP të lidhur me sektorin, por ka më shumë gjasa të jetë një shenjë mungese të kontrollit dhe të kuptuarit të PPP/LFT-së në këtë sektor.

Cenueshmëria e përgjithshme

Përderisa ekzistojnë boshllëqe të inteligjencës në lidhje me shkallën e plotë të të ardhurave që pastrohen si rezultat i përfshirjes së sektorit të shërbimeve të kontabilitetit, nuk besohet se sektori është duke u përdorur në mënyrë aktive për PP në një shkallë më të madhe, megjithatë kontrollet dhe të kuptuarit e PPP/LFT-së nga sektori ka të ngjarë të kenë të meta domethënëse.

Kazinot në Internet

Paraqesin cenueshmëri **të ulët** nga pastrimi i parave

Nuk ekziston një kornizë ligjore që rregullon bixhozin në internet, gjegjësisht nuk ka licencim ose rregullore, kështu që lojtarët mund të luajnë në çdo faqe interneti që dëshirojnë. Lotaria e Kosovës deri në vitin 2019 ka ofruar lojërë të lotarive online (pa i përfshirë bastet sportive).

Cenueshmëritë e pandara/ të brendshme

Ky sektor nuk është i rregulluar dhe funksionon pa mbikëqyrje për PP dhe çështje të tjera. Disponueshmëria e bollshme e lojërave të fatit dhe basteve në internet, i kombinuar me qasjen e lehtë nëpërmjet faqeve të internetit, qoftë në kompjuterë apo në pajisjet mobile, do të thotë se është jashtëzakonisht e lehtë për individët që të kenë qasje në këtë treg pa mbikëqyrje. Monedhat virtuale përgjithësisht konsiderohen me rrezik të lartë për PP, dhe disa prej kazinove në internet ka të ngjarë t'i pranojnë, por deri më tani, në Kosovë nuk janë zbuluar raste të PP-së përmes monedhës virtuale.

Kontrollet për PP/FT

Një tipar i rëndësishëm i lojërave të fatit në internet është se pagesat duhet të bëhen përmes transfertave elektronike, prandaj pagesat direkte me para të gatshme janë të pamundura, por së pari duhet të hyjnë në sistemin financiar, prandaj, në përgjithësi asetëve u duhet t'i anashkalojnë kontrollet e sektorit bankar. Të gjitha transaksionet bëhen online përmes ndërveprimeve jo sy-më-sy dhe përdoruesit duhet të regjistrohen për ta përdorur faqen, si dhe duhet të sigurojnë një metodë të pagesës (p.sh. kartelë krediti ose debiti), edhe pse kjo e zvogëlon anonimitetin e mbajtësit të llogarisë, prapë se prapë kjo e bën të vështirë të përcaktohet se kush është në kontroll të llogarisë.

Cenueshmëria e përgjithshme

Pavarësisht se sektori është pa mbikëqyrje dhe rregullore, fakti që së pari fondet duhet të hyjnë në sektorin financiar, në përgjithësi duket se e bën të pafavorshëm për metoda të tjera më të thjeshta të pastrimit.